

Musa Lamallari

2001 - FUNDI I BOTES

**Shtepia botuese URTESIA
Shkup, 1996**

UNE DHE ZOTI

1

**KUSH E NJEH VETVETEN - E NJEH Zotin!
(Ebu Bekri r.a.)**

**PENDOHEM
PER ATE QE E KAM THENE,
PER ATE QE E KAM BERE,
PER ATE QE E KAM DEGJUAR...
POR KURREN E KURRES...
NUK PENDOHEM
PER ATE QE E KAM SHKRUAR!?**

**DUA TE CLIROHEM
NGA ANKTHI I KATER MUREVE,
NGA ANKTHI I NEVERISE SE SARTRIT.
DUA DHE MUNDEM.
MENDOJ DHE SHPRESOJ
PER DRITEN
NGA BOTA E HICIT
NE BOTEN E FICIT!...**

Autori

NE VEND TE PROLOGUT

NE KERKIMIN E MUZES SE HUMBUR

E shoh Piramiden e Keopsit. Aty, afer, ne vetmi. Qendron si nje hallke e ndryshkur e ngulfatur me trupa te ballsamuar dhe me faraone, ne korridoret e se ciles jane vizatuar cdokund tri simbole. E ne dhomen 2001, mbi fron rri Perbindeshi, ne stilin e Iblisit, dhe kjo Piramide e cuditshme e beri boten te jetonte ne vlime te medha. Ky ishte rezultat i hipokrizise dhe kulm i degradimit shpirteror ne bote.

Nuk po e shoh nga po bie ky terr, si komete, kur tymi I Iblisit ben mjegullen dhe humb Driten e Shpetimit. Ne kete mjegullnaje njerezit hyjne dhe dalin viktima si fantazmat qe humbasin ne erresiren e nates, ku nuk do te gjejne vecse germadha!...

Dhe, nga kjo pamje e trishtueshme, UNE iiiikk..? - thirra thekshem me tere fuqine dhe shkrova:

**Me mbytni
O njerez dhe ju...
"te fjales dhe te beses"
Jeta ime
Locka ime e dashura ime
Fillon
Ne mbytjen dhe ne zhdukjen time
Leviz
Jeta pas vdekjes
Ne jete...**

Gjersa isha ne ikje dhe largohesha nga paqja e trishtueshme servile ndieja lodhje dhe merzi. Kisha vene re se ndodhte shpesh te lexoja poezi mistike, per te cilat thosha me pas: ku jam une eshte Fati. Ose ku e gjeta muzen mistike per ta pare ate rrotullim ne Fat. Dhe gjithmone mendoja: pse nuk isha larguar pak me heret, ose pse nuk kishte shkak te lexoja poezi mistike, qe te kerkoja muzen ne kohen e humbur. Por, largimi ishte shkak qe kerkonte rrotullim dhe shkak spontan ndoshta sjell Fat. Keshtu njeriu eshte I detyruar te enderron Brenda rrotullimit shijen e Fatit dhe ta prese ardhjen e Fatit ne ardhmeri.

E ndieja se isha nervoz: here me te tjeret, po me shume me veten time. Ndoshta isha une vete qe e krijoja kete mbytje. Ishte mendja ime e lire, se ciles I dukej e padenje qe imami te dilte te personifikonte jeten qe me pahiri eshte verberuar ne labirintin e korridoreve te fronit te Reisit ne Piramiden e Keopsit.

TASH PERSERI KTHIM

Ku e di une se a eshte ky "Liber" aq i denje per botim? Ajo cka une do ta permbledh ne kete liber eshte shpalim i jetes sime dhe shitje e dhembjeve qe te mos lengoj nga frika... Te mos e le vetveten ne ankth; ne verberine e jetes, dhe publikun ne terr, ne tymin e Iblisit.

Behet mire nese (nuk) I ndezi fletet e shkruar te ketij "Libri". Une e pergatit librin e pare. "Libri" (nese) del Neser, Une dhe shkrimi im do te jemi ne skene. Mua, fundja, askush nuk me njeh, por fletet e shkruara do t'I shploje para publikut Libri, ku do te me duket shpirti I imamit I veshur me driten e Zotit, qe do te me beje te "famshem" pas vdekjes(?). Por vetem dicka. Punet dhe mendimet e nje imami jane librat e tij qe paraqesin vleren e tij ne shoqeri.

"Dituria pa vepra eshte marrezi e vertete, kurse vepra pa dituri as qe mund te ekzistoje", thoshte imam Gazaliu. Pra, une jam "karrieriste", pervec kur rri prane tavolines dhe e lexoj imam Gazaliun si me keshillon:"Do te jesh I mallkuar, nese gjumin tend e ke flijuar qe (me kete "Liber") te arrish pozite te laverdishme, pasurim dhe tejkalim te shoqeve te tu, mjeri ti, dhe prape mjeri ti!"

Te ndjekish me kujdes dinamiken e kesaj keshille, qe eshte nje altruizem I fuqishem ne thesarin islam, do te thote te mos heqish dore nga puna e krijimit, sepse pikerisht me kete do ta forcosh dhe gjallerosh mendimin Islam, do ta perhapesh idene e lirise dhe "Do ta pengosh e do ta shkaterrosh epshin, I cili shpie vetem kah e keqja, dhe, nese pershkohesh me kete ndjenje, I lumi ti! - perfundonte ne keshillen e vet imam Gazaliu.

Qe te mos heq dore nga puna e krijimit, mesova mire e mire disa lemenj te Islamit dhe biografine e bujshme te Pejgamberit, qe te jem me afer thesarit Islam dhe me afer Allahut te madherishem, kurse jeta tragjike

e mendimtareve Islam do te jete shembull I mire per mua qe ende nuk e kam botuar "Librin". Megjithese ne "Liber" dukem se orvatem me lloj-lloj menurash, jeta ime ka vetem nje qellim." Une deshiroj me gjithë qenien time qe te arrij nje pikesynim te madh. Kushedi se a do te vije dita te shkruaj ndonjehere per kete qellim. Me sa mund ta marr me mend sa e rende do te jete dalja nga labirinthe I Iblisit, aq me teper do te mund te pershkruaj boshtin e ideologjise Islame. Po punoj per kete gje me zell, pa u ndalur nga asnjera prej atyre shigjetave te shpeshata, qe I gjuanin matrapazet e klanit te inkuzicionit ne mendimin e lire Islam.

Ne qofte se flase per njerezit e klanit te inkouzicionit, atehere kjo pse jam I detyruar t'I permbahem ndergjegjes njerezore, drejtesise dhe sacrifices, te cilat me kane larguar nga ombrella e klanit te inkouzicionit: "Interesi Islam eshte interes I fronit te Reisit ne Cairska 52". Kjo ombrelle e ka ngulfatur metodologjine e veprimit Islam. Ndoshta, ky eshte shkaku pse largimi im ze fill duke u ngulfatur bashkesia e muslimaneve ne feliqesirat e matrapazeve te klanit te inkouzicionit.

Bota e jashtme, sipas Ali Sheriatit, per syte e nje individi, eshte nje fotografi e shoqerise se vet, ashtu si edhe pozita e tij sociale, qe reflektohet ne pasqyren e realitetit dhe subjektivitetit. Ndersa, sa I perket jetes sime, une jam I vetedijshem se "Libri" im qe eshte I ngjyrosur me Fatin dhe fjalen e shkruar, shpreh pozicionin dhe rrefimin per nje shoqeri, qe me pahiri eshte verberuar ne labirinthin e Piramides se Keopsit. E edhe une jam future ne labirinthin e kesaj verberie, por jo edhe vizioni Islam I shprehur ne kete "Liber", e ky I fundit eshte qe ai te me mbroje, se nesor askush s'do te di cili isha une, e edhe une, fundja, do te vdes. Domethene, si sherim te vetem dhe me te madh do ta kem vdekjen. Vdekja eshte ilac I Zotit dhe melhem qe I vendohet njeriut nje here ne jete. Dhe, gjersa te vije ky melhem, edhe une jetoj dhe veproj Brenda nje pellembe toke. Kam, ne fund te fundit, nje grimce shprese, ku kapem dhe enderroj, pastaj e pres Fatin qe ta rrenon Piramiden e Keopsit!

Fati me ngjyren e shkrimit ne "Liber" nuk eshte pune immediate, nuk eshte pune inkouzicioniste, partiake, perkundrazi, eshte pjelle e individit ne shoqeri, qe di ta dalloje te miren nga cdo gje tjeter dhe ta percaktoje, qe nuk pranon nga jashte t'I percaktoje e t'I imponoje klani

I inkouzicionit se c'eshte e mire, e keqe, e moralshme a e pamoralshme, keshtu qe ai (individi) si kriter per vleresimin e veprimeve te njeriut e merr ndergjegjen dhe vizionin Islam, e jo dekorin e fese se inkouzicionit qe eshte pjelle e labirinhtit te Iblisit ne Piramiden e Keopsit.

Nje here ne "Flake" pata shkruar:

"Ne natyre: njerezit vijne e shkojne. Kjo eshte jeta... Toka... Aty ku lind e vdes trupi, ku krijohet e rrenohet arti. Kurse nuk lind e nuk vdes Fati me ngjyren e shkrimit ne leter, nuk plagoset e nuk rrenohet vetem Fati. Vetem LIRIA...

PENDIMI ESHTE PASTRIM I SHPIRTIT

Vitet po ikin e une Brenda kater mureve I vetmuar gjykoj. Nuk me kujtohet saktesisht. Ishte para kater viteve. Por gjithnje, a jam I obliguar ta shkruaj vitin..? Sonte me kujtohet vetem "Parku I bekuar"! Kush e di per te saten here edhe sonte therras: "O lidera, o byrokrate, o efendilere, o bakllavamena... Vetem nje armik e keni - ata e njohin me mire se sa e njeh ti, o Musa!" Valle frikesohen? Une e di. Per arsye se une isha midis njerezve filistine te konvertuar ne puthadore "patriote". Krejt ajo ishte detyre e "shenjte"...Aksiome. Dogme... Cdo gje ishte ashtu sic ishte. Besa edhe idealizem. Metafizike e vetekenaqesise. Po edhe sensualizem. Art. E gjithë kjo ishte ankth. Neveri. Makebth. Burg. Legjende. Trendafil. Dashuri. E cka nuk ishte?

Pse dhe sa isha I konvertuar ne misionin e "shenjte"? Kisha ngrene frytin e parajses. Sepse vetem atehere une u shtangova dhe ndjeva turpin. U gjunjezova ne dheun tim pa me terheq zvarre drejtesia. Sepse; ne boten e vetmise, ndjeva se me pushtoi drithme frike. E cuditshme ishte kjo ndjenje, here e gjalle, here e permotshme. Duke pritur te ma sjell pendimin. Kisha vene re se friken e zevendesonte vetem pendimi dhe pastrimi I shpirtit.

Pasi u thellova me kujdes ne forcen e ketij pendimi, qe eshte nje nga me te singertit ne boten e vetmise, kuptova se ai perbehet nga tri impulse. Casti i pare: pasi e theva ligjin e Zotit ne parajse, Zoti me dha liri, aq shume sa me zbreti ne toke, e me tha: Djalli dhe epshi yt jane armiq te perbetuar ne jeten tende. Casti I dyte: Pasi e pashe trupin lakuriq, Zoti

me dha sens aq shume sa ndjeva turpin, e me tha: Largohu nga parajsa, meso (tre here). Dhe, ne castin e fundit une e bera nje zbulim. Casti I trete: Pasi me pushtoi nje drithme frike, Zoti me dha fuqi dhe u pendova, e pastaj e gjeta veten ne toke, ne teater... Por aty s'isha regjisor dhe s'kisha as vule. Te regjistroje e te c'regjistroje artiste. T'I ngjalli, t'I vdesi, prape t'I ngjalli per t'I vdekur perseri. Mos valle, do te me kuptoni gabimisht?

REBELIMI OSE RETROSPEKTIVE NE QENDRIMET DIVERGJENTE

A e dini ju se s'ka gje me te neveritshme sesa ta shpjegosh idene e inkouzicionit ne Cairska 52 dhe aq me pak rrethanat qe e kane imponuar fronin e Reisit ne shoqerine qe bene perpjekje per ta rrenuar Piramiden e Keopsit?

Valle, une a nuk isha dhe si isha ne skenen ku binte vetem nje shuk drite, ne teatrin e artit absurd te nje auditori. Nuk ka dyshim. Por aty nuk isha filistin dhe puthador. Ne kete jam I sigurte me shume se shtateqind mije here... Perndryshe do te isha filistin dhe puthador. [Nuk do ta shkruaja kete "Liber". Nuk do te rebelohesha (pendohesha). O Zot! U ka mbetur vetem nje atu te me sulmojne: rebelimi! Po cka ndodhi me faktin qe deshmon se gati shtate vjet po behen qe kur puna dhe shkrimi im akuzohen per rebelizem. Cfare njeriu do te isha sikur te mos me konsideronin here pas here te rebeluar. O Zot! Une u pendova dhe e hudha rebelimin vetem ne shkrim. Per inat te inkouzicionit dhe fronit te Reisit. Per te deshmuar lirine e mendimit ne leter. Pse? Une e di. Ckado qe te shkruaj, nuk u pelqen ithtareve te inkouzixionit. Ata nuk me duan, me duan te heshtur dhe vetem ne forme imam, qe do te thote te vdekur per se gjalli!?

Une isha I vetem, mendimi I lire Islam nuk I bindet shkopit te dirigjentit, kurse kundruall une nuk dirigjoja me asnjerin nga instrumentet ne orkester... Por atebote, a me mungonte guximi (apo ishte dicka tjeter ne pyetje) qe nuk u futa ne lufte kunder qendrimet puritan?... Mendimi i lire Islam eshte shprehje e vullnetit te Zotit; prirje abiljane. Te kesh guxim te dalesh ne skene dhe ta nxjerrish aty vyrtytin e drejtesise. Ndoshta shkrimet e ardhshme do ta dekonspirojne

ne nje fare menyre qendrimet divergjente dhe perimtimin e shkaqeve, sepse vetem atehere behet I padurueshem inkouzicioni I cfaredo tipi e lloji nga te qendruarit indifferent pikerisht para labirinthit te Reisit ne Piramiden e Keopsit.

Te vesh xhybe dhe callme, te akumulosh ne vetvete avanturizem intelektual dhe te mbeshtetesh ne fronin e inkouzicionit, s'eshte progress Islam, eshte regres dhe shenje e ambicieve te semura patologjike per degjenerimin e natyres Islame, kurse para audotiriumit ne TV te eksponohesh vetem si nostalgji, me xhybe dhe me callme, madje si dirigjues I tille t'I imponohesh pa pergjegjesi subjective Islamit, - ky eshte mekat. Dhe nuk eshte mekat I vogel. Qe mekati te jete edhe me I madh bashkohen semundja dhe vesi: perversioni dhe hipokrizia.

Te gjitha le t'I gezohen demokracise ne labirinthin e Iblisit, kjo eshte liria dhe e drejta e gjithsecilit. Nese edhe mua si njeri me takon nje trohe liri, atehere e shfrytezoj lirine te them se kurre nuk kam qene me I gezuar sesa kur e humba durimin per t'I degjuar sloganet e demagogjike te Reisit ne fronin e inkouzicionit. Une tash perpiqem te jem vetem rebel I shkrimit per te shpetuar njerezit nga mallkimi I Reisit ne Piramiden e Keopsit. Kurse grupet e xhematit (popullit) nuk e dine se mjegullnaja te deperton ne mushkerite e bardha kur frymon midis puthadoreve te reisit te konvertuar ne "patriote" fetare!(?) O Zot! A vetem nesor, si ushtria e faraonit ne detin e kuq, binden se ishin robber te epsheve dhe iluzioneve te tyre. Por atehere, a nuk eshte vone?...

UNE JAM SHENJE E IDEOLOGJISE

Guri, I fundit, a u hudh aty ku beri folene djalli, ne nje koder ne Meke? Njeriun (e jo djallin) duhet gjuajtur me gurez: jo pra, ne kodren e Mekes, por ne Cairska 52. Ne punetorine time per te pervetesuar boshtin e ideologjise Islame me ka ndodhur t'I fuse ne analiza mendimet e predikuesve te inkouzicionit. Fjalet kur hudhen si gures ne kodren e Mekes, prej zhurmes se madhe te haxhinjeve, ndodh te mos I degjoje askush, te humbin ne pluhurin e shkretetires, por kur I fute ne shkrim, pa etike dhe pa pergjegjesi, boshti I ideologjise Islame te jepe mundesi per analize te arsyeshme dhe ta zbulon shterpesine dhe perfeditetin e predikuesve te inkouzicionit. A ju ka ndodhur te degjoni sa bukur

ligjerojne predikuesit e inkouzicionit ne tribuna, ne TV, para tabutit te xhenazes (qe rri shtrire mbi pllaken e bardhe te gurit) qe pret te mbulohet me dheun e zi), po pse nuk kane kreacion dhe pune konkrete aq shume sa ligjerojne...? Predikuesit e inkouzicionit nuk dine te punojne me kreacion dhe pune konkrete. Ata punojne me prepotence dhe me qendrimet pragmatike per te pergatitur kurthe per kundersharet e inkouzicionit ne labirinthin e Iblisit. Domethene, ligjeraten e kane vetem akt te diversionit mbase ata mbeshtetjen e kane ne "sovrانيتin" e Piramides se Keopsit!

Predikuesit e inkouzicionit ne Cairska 52 vetem atehere kur ne pyetje eshte kreacioni dhe puna konkrete jane apolitike dhe me prepotence te vazhdueshme kundershtojne ideologjine Islame. Mirepo, qendrimi apolitik dhe mbyllja hermetike ne labirinthin e fronit te Reisit kurre nuk kane mundur ta mposhtin distrikcionin e shpirtit te verber. A nuk po shihni se fije turpi nuk kane dhe deri kur do te binden se duhet t'ju nenshtrohen ligjeve te drejtesise Islame? Keta jane adaptuar ne fronin e labirinthit te Reisit dhe jane mesuar t'ia mbulojne njeri-tjetrit prepotencen me buzeqeshje te vizatuar, pikerisht si ne (Ali Imran 119 "e kur u takojne juve thone:"Ne kemi besuar"! E kur vecohen, ata nga mllef i kunder jush grisin majet e gishterinjeve. Thuaju:"Vdisni me ate mllef tuajin!" Allahu e di shume mire se cka bejne zemrat e tyre").

Une jetoj midis predikuesve te inkouzicionit dhe politikaneve te konvertuar ne demokrate "fetare", te cilet refuzojne me prepotence ideologjine Islame. Thuajse besimi islam, pergjegjesia dhe lufta nuk jane natyre dhe shenje e ideologjise. Por une nuk guxoj te them keshtu, se jetoj mes tyre... Keshtu mund te zemerohet fronti I Reisit. Une them, feja eshte jete dhe gjithsecili e ka fene e vet, por ideologjia Islame eshte bosht I punes dhe eshte e vetmja qe e instrumentalizon botekuptimin fetar ne jeten tone praktike. Jo, veshtire eshte te thuhet keshtu, se a e dini cka e gjeti Sejid Kutbin dhe Ali Sheriatin, kur njerin e varren dhe tjetrin e mbyten. Ku e di une se cfare islami kerkon fronti I Reisit ne Cairska 52: indiferencohen edhe kur ndokush tjetër (si gjaku I te rreneve per liri) e dikton luften kunder pushtuesit slave! Ndoshta e kane pervetesuar "misticizmin" kolektiv aq shume, sa edhe kategorite luftarake te moralit Islam I'a nenshtrojne "ores se lige te sufizmit" pragmatic. Po te ishte keshtu, Zoti do te luftonte ne vend te Pejgamberit S>A>V>S>!?

Behet mire nese (nuk) bej shikim ne retrospektive. Dikur, ne vitert 1988 (sa kohe e larget, o Zot), shkrova SAFFS, dhe asocijoja ne njohjen dhe domosdoshmerine e metodologjise kur'anore, ne praktiken dhe ideologjizimin e fese islame. Shkrimi im thoshte: Une jam shenje e ideologjise. Une jam nga masat te cilat, si pararoje e lartesar I kane filluar lufterat ne epoken e histories; ata vdiqen dhe presin te vdesin". Ta citoje edhe nje here Ali Sheriatin: "Besimi, pergjegjesia dhe lufta jane natyra dhe shenja e ideologjise". Po te mos ishte keshtu, Ali Sheriati nuk do te vriteshte ne Londer. Ne kajro nuk do te varreshte Sejid Kutbi. Dhe gjaku me I mire I popullit tim nuk do te derdheshte neper rruget e Evropes! Mos valle, edhe tash nuk po e kuptoni se cka eshte ideologjia?

Feja Islame nuk eshte vetem fe, ndjenje dhe ritual qe permbaron vetem nje aspect te jetes, as nuk mund te themi se Islami eshte vetem thirrje morale, gjithashtu nuk mund te thuhet se Islami eshte vetem system per regjim, ose system per ekonomi, ose system per marrdhenie nderkombetare... "Te gjitha keto jane lemi te menjanuara prej lemive te shumenumerta te Islamit". Domethene, "Nese nuk e kuptojme natyren Islame si nje fe te kompletuar, atehere veshtire e kemi ta kuptojme cdo lemi te menjanuar prej lemive te shumenumerta te Islamit..." - thoshte Sejid Kutbi.

Dhe, ne fund, "Libri" (nese) del Neser, gjithë cka ne te eshte vetem art: Fat dhe Fitore!

BOTA E VETMISE

2

**VETMIA ESHTË FAT I SHPIRTRAVE TE JASHTEZAKONSHËM
(Shopenhaueri)**

Njeriun ne rrugen e tij evolutive e kane percjellur gjithmone pasionet. Ato shpesh jane kuptuar me euforine e epshit, prej asaj cka kemi qene, me lakmi per ate cka deshirojme te behemi dhe, per realizimin e kesaj deshire, pamja jone e jashtme mbulohet me pluhurin e pudres se Iblisit. Me kete dekor te Iblisit harrojme per Cka dhe Pse jemi? Nga fakti se pamjes sone ndaj Zotit nuk I perkushtojme asnje ore kujdes dhe rendesi. Nje kujdes I ketille, kur futemi ne boten e vetmise, ndihmon dhe lehteson reintegrimin e engjullores ne entitetin e shpirtit tone. Kete jo vetem qe do ta kemi thesar te shprehur dhe levizje creative ne jete, por edhe pasionet tona do te rrijne te shtruara, te vendosura e te padjallezuara dhe do te bejne gjume te rehatshem ne boten e vetmise, per te cilen jemi pergjegjes tere jeten, duke u kujdesur dhe duke shpresuar se kur nuk do te gabojme ne jete. Kujdes ne boten e vetmise!

C'ESHTE BOTA E VETMISE?

Ne realitet, bota e vetmise, per syte e nje individi, eshte nje fotografi e persekutimit shpirtor ose, me fjale te tjera, nje sjellje lakuriqe e shpirtit ne raftet e vitrines ku ballafaqohet me hijen e gjenive te botes, ashtu si edhe pozita e tij intelektuale qe reflektohet ne pasqyren e realitetit dhe subjektivitetit. "Vetmia eshte fat I shpitrave te jashtezakonshem", thoshte Shopenhaueri. Boten e vetmise mund ta kuptoje vetem imazhi I forces se intelektit te individit dhe intuita e tij fitohet me ndergjegjen e formuar se askush nuk ben te vritet pas shpine!

Bota e vetmise, bote e fshehte dhe diskrete, bote e gjithe asaj cka nuk do te lejonim per ne te dihet, bote ne te cilen mendojme momentin kur nga qenia jone shperthen destrktiviteti, analogjia e Iblisit; erresira, e cila pershkohet me ankth pikerisht kur gjindemi Brenda kater mureve, sepse ajo atehere na sjell vetem ballafaqime te semura. Keto ballafaqime te padeshiruara prekin ate vend ne te cilin jemi lendum dhe te dobet me se tepermi, prandaj goditjet e fatit, te cilat vijne permes kesaj vije, aq rend na prekin.

Krejt ajo e fshehte dhe misterioze, lindja, vdekja, transformimi dhe shume vdekje te vogla dhe lindjet e serishme, te cilat ne forma e klasifikime te ndryshme tipologjizojne jeten tone te sotme, - te gjitha

keto jane pjelle dhe burojne prej asaj qe quhet bote e vetmise. Ndersa ajo eshte dera e mistereve - para se te zgjohen ndjenjat dhe pasionet tona, e ajo me shume eshte bote e iracionales sesa racionales, e erresires ku duket qe edhe dyert kane sy, ndersa muret veshe dhe pas te cilave rri hija e gjithë asaj cka ne jete e kemi bere, a nuk eshte dashur, ose; po, nuk e kemi bere, a eshte dashur ta bejme!?

KOHA PARA SE TE NGRYSET

Bota e vetmise kujton ne menyre sublime ndjenjat dhe pasionet e gabimeve tona, jo vetem prej atij casti kur gjindemi Brenda kater mureve, vet me vetveten, por edhe prej nje vargu te serive nga jeta e kaluar. Aty ke mundesi ta ushtrosh shpirtin dhe te vesh cdo gje nen kontroll.

Bota e vetmise eshte thellesia e brendshme dhe si dhembje rrenuese, qe banon ne jete, godet me shigjete helmuese vete entitetin e shpirtit tone, me te gjitha ato caste te jetes te cilat I kemi kaluar dhe shenuar si ore te KOHES SE LIGE. Prekja e ligeshtise ne boten e vetmise eshte thellesia e krizes sone, me ekzakte, aty shfaqet kauzaliteti I te gjitha thellesive te brendshme, te casteve qe kemi mbijetuar dhe qe presim te mbijetojme. Ketu eshte e vulosur ajo e njohura dhe e panjohura, aty gjindet dilemma me e madhe, faza e kontradiktave te cilat sjellin konflikte, e mepastaj vijne arsyetimet e njepasnjeshme, perkatesisht kur zgjedhim: TE MIREN ose TE KEQES!

Sa e mira aq edhe e keqja, ne menyre permanente, jane te njohura, qofshin edhe sa grimca ne peshoje. Keto dy kundertshti te medha, perkunder qe mistifikohen ne boten e vetmise, jane sensible dhe nje dite do te prekin ndergjegjen njerezore. Keshtu, meqenese e njohura eshte veprim I kryer - ajo shpesh nuk duron kurrfare arsyetimesh. Eshte shume e vertete se, kur vepron ne labirinthin e Iblisit dhe me njerezit hipokrit, nuk duhet te shpejtohet me arsyetime, sepse vet ngjarjet do te na zbulojne te verteten. Perndryshe, nese shprehim arsyetimet rreth te Mires dhe te Keqes, atehere kjo eshte marrezi e madhe, vecanerisht kur kjo behet "Ne rendin kabiljan qe bazohet ne monopol ekonomik, politik dhe ne monopolizimin e fese".

Nderkaq, sekreti I frikes dhe e panjohura, ne thellesiine e botes se vetmise, eshte Fati yne dhe ne jemi ata qe prej aty e sendertojme Fitoren dhe ardhmerine tone. Njeriu I races sone duhet t'I kundervihet rendit kabiljan dhe duhet te kete energji si edhe imazh te forces intelektuale per ta permbyse ate rend qe bazohet ne eksploatimin dhe roberimin e njerezve.

Futja ne lufte kunder rendit kabiljan (sipas Sheriatit), ma perkujton ate ironin e ketij iraniani mbi virtytin dhe drejtesine njerezore te Abilit. Nje virtyt dhe drejtesi njerezore prejjudikon edhe pasusi I funditr I Sheriatit: "Domethene, me zhdukjen e Abilit, historia hyn ne epoken "kabiljane", e ne, qe te gjithë jemi pasardhes te Kabilit, pasi Abili asnjehere nuk u martua".

Indiferenca jone e plote ne skene sjell konformizem, ose arsytetime te njepasnjeshme, ne vecanti kur duhet te zgjedhur: te Miren (Abilin) ose te Keqen (Kabilin). Mirepo, kur nuk gjindet shtegdalje, duhet patjeter te percaktohem per njeran ane, dhe t'I permbahemi pastaj atij boshti te pikepamjeve te formoluara e te pervetesuar ne boten e vetmise, keshtu qe, kur inkorporohemi ne rrjedhat e kohes dhe ne aktivitetin praktik te jetes, eshte gabim te thuhet se te gjithë kane zgjedhur anen e Mire, edhe pse te gjithë me zerin deklarative pretendojne ne ate.

Per shembull, shfaqja e pasioneve egoiste, uzurpuese dhe perverse, sipas ithtareve te Kabilit, nuk jane ne kundershtrim me parimet e te drejtes dhe te lirise se njerezve qe qyteterimi bashkekohor I ka te theksuara ne kodet e veta. Ndoshta pse ithtaret e races se Kabilit jane vete qyteterimi bashkekohor dhe, si zoterues te qyteterimit, kane karakter te dobet dhe jane te korruptuar ne disfavor te se "Mires", apo pse keta posedojne edhe entuziazem qe eshte I njejte si ai I faraonit, I cili pati guximin dhe kete e deklaroi, perkunder njerezve te qyteterimit te sotem te cilet kete gje e fshehin.

Ata qe I shkruan keto kode jane mashtrues te shpirtit; keshtu I sherbyen Kabilit. Pse Abili ne start u mbyt dhe u be factor per te vertetuar gjithmone ne histori lirine, te drejttat dhe virtytet e njerezve. Raca e ithtareve te Abilit eshte e vertete se nuk u beson mashtruesve te shpirtit! Po te mos ishte keshtu, Pejgamberi S.A.V.S. nuk do te thoshte: "A qe ne rendin kabiljan thote: JO - do te jete bashke me mua

ne xhenet". Kete e provon para Kalifit mendimtari I lire Islam, Numan bin Thabit dhe thote: "JO. Kjo JO ate e fut ne burg. A e dini ju se nuk u lind kot "Medh'hebi Hanefi"?

KOHA PARA SE TE GDHIJ

Ne boten e vetmise, sote me shume se dje, eshte ne levizje egjra dhe, mos kthimi ne Zotin, eshte me e keqja nga te gjitha, pasi ky ves njeriun e ben te roberuar aty ku ankthi e ka fjalen dhe ne forma te ndryshme e perveteson ne boten e hiqit. Ky pervetesim njeriun e peshon edhe ne nihilizem. Aty me nuk eshte ai cka duheshte te ishte! Po pse te jete?! Secili ne forma te ndryshme eshte korrumpuar, ose eshte bere rob I pasioneve te percudshme, ose eshte pajtuar me ankthin e rendit kabiljan, mbase ky rend eshte pamja e jetes se tij dhe mbase ai eshte involvuar ne te me shume se dje. Ndoshta eshte aq I deshiruar ne te saqe mendja I eshte verberuar dhe aty me nuk sheh kurrfare shtegdalje. Kjo tashme eshte fotografia e tij e vertete, ne pasqyren e sotshme te botes se vetmise, me shume destructive dhe shume reale dhe relevante per Iblisin. A thua, valle, e kuptojme kete?

Ne kete ballafaqim vetkontrolla e gjertanishme behet armiku yne me I madh. Veni re: bota e vetmise shnderrohet ne Burgun e vetmise. Krejt ajo kunder te ciles luftojme: ne ate cast - jemi ne vet! Mirepo, impulsi per lufte eshte shume I forte, sepse e forte eshte edhe frika. Kush mund ta percaktoj se cilen skute te hipizmit na preferon, ndoshta aty ku do te mbesim pa themel, pa pikembeshtetje!? Ky eshte burgu I vetmise ne KOHEN PARA SE TE GDHIJ dhe behet mundim: "per gjithcka e per asgje". Mbi gjithcka rikumbon mendimi modern I materializuar ne stilin e Iblisit, me intence qe ky stil te bej degradimin e natyres Islame, te asaj shpirterores ne hic. Dhe mbi hic shfrenohen pasionet e kerkesave tona te percudtshme dhe kalohet ne stadiumin e idiotizmit. Provohet edhe me e keqja. Por...valle, a e kuptojme?

Pika e pare e gjakut cka u derdh ne toke, per ithtaret e Kabilit, verteton se lakmia per seks mund te kuptohet pushtet dhe fuqi, njejte sikur edhe parate, keshtu qe, me posedimin e ketyre dy gjerave, do te mund me mire qe ta zoterojme jeten ne boten e hiqit. Ky kuptim ne kokat e races se ketille te njerezve ngulitet me bindjen se do te mund t'I kenaqin pasionet e percudtshme ne stadiumine idiotizmit. Aty ku ben vetvrasje Kleopatra. Ata u nenshtrohen pikepamjeve perverse dhe lidhin besen

me Iblisin pikerisht ne burgun e vetmise. Fundi I hicit eshte katastrofe e njeriut pa Iblisin.

Burgu I vetmise eshte I pershkruar bukur mire ne ngjarjen biblike per popullin e Lutit ne Sadum. Populli I Sadumit ishte I pasionuar pas puneve te ndyta: seksit oral dhe pederostise, qe deri atehere ishin te panjohura. Per kete arsye Zoti I dergoi tre engjej per ta lajmeruar Lutin se ka per ta zhdukur popullin e Sadumit. Ndoshta virusi I Sides per here te pare u sherua ne Sadum, ndersa gurezit e qiellit ishin si ilac. Zoti e pate denuar kete popull dhe e pate shkatrruar kete qytet me gurez. Tre engjej Lutit I thane: "Ti merri dy vajzat tua dhe largohu nga ky vend, kurse bashkeshorten tende lere ketu, se edhe ajo eshte me ata te pafete". Dhe Luti dy vajzave te veta u tha: "Mos u ktheni se, nese shikimi juaj edhe nje here bjen ne kete qytet, do te ngriheni, do te shnderroheni ne gurez".

**Larga nga burgu I vetmise!
Afer eshte viti 2001!**

PO.(Et Tine -4, 5 "Vertete, Ne e krijuam njeriun ne formen me te bukur. Pastaj e zbritem ate ne me te ultin e te ulteve!) Qenia yne eshte fakt se behet me e ulet, kur njeriun e mund monopoli I epshit dhe behet I percudshem ne cdo pikepamje ne jete. Krejt ate egjer cka, deri me tash e kemi kaperdire ne vete, pa ndare grurin nga ajo, me ne fund, ngre koken e vet, fotografon njeriun sic eshte ne realitet, zbulon levizjet ne cdo skute, imiton prirjet seksuale ne shtrat, shtremberon figuren e njeriut, pasi ai vet e ka perulur vetveten. Sa dallim I madh me deven! Pse devja nese e perul vetveten ben vetvrasje!

Tere ate qe hipokrizisht e kemi thene dhe bere ne jete, krejt konstruktiviteti yne I rrejshem, tash shfaqet haptazi dhe sinjalizon formen destructive te aktivitetit tone, vepren e madhe te Iblisit. Kush mund te na prejudioj sa mund dhe sa duhet te jemi te djallezuar ose te padjallezuar, me shume ose me pak sesa jemi ne vete ne te vertete, - nese nuk e pranojme pikesepari ate qe kemi thene dhe bere hipokrizisht ne jete. Ndoshta, ky eshte shkakun pse vepra e Iblisit ze fill duke e privuar engjulloren nga entiteti I shpirtit tone (mbase per shkak se analogjia ne boten e vetmise eshte formuluar mbi fenomenin: zjarr). Prandaj, ka aq shume njerez qe nuk u pelqen predispozicioni hyjnor; prandaj ka shume njerez qe boten e vetmise e kuptojne gabimisht dhe

shume pak seriozisht, dhe pastaj eshte krejt normale pse mbyllen ne burgun e vetmise, ku marrezia dhe hipokrizia jane cilesite pas te cilave njerezit mbeshteten me frike se do te pesojne ne jete, kurse vdekja (per se gjalli) fillon t'I frikesoje, pasi jane te vetedijshem per jeten cfare e kane dhe si jane te vetedijshem per jeten cfare e kane dhe si jane duke e udhehequr ne labirinthin e Iblisit

KOHA NE RROTULLIM

Gjate jetes sone duke e jetuar perditshmerine, shpesh I apostrofojme pasionet e percludshme si jo te qelluara, duke I karakterizuar si ta pahijshme, te poshtera dhe te panevojshme, pasi qe e dijme se jane pjelle e Iblisit ne burgun e vetmise. Keto jane caste kur ne qenien tone fillon te levize dicka e re, nje fuqi qe do te kete gatishmeri ndryshimi dhe do te tregon reflekse drejt avancimit te engjellores ne entitetin e shpirtit tone. Ne keto caste, me levizjen e kesaj fuqie te re, kushtimisht levize dhe ze fill KOHA NE RROTULLIM dhe eshte ripertirje e vetmise: Kthim ne Zotin. Dhe, ketu, burgu I vetmise rikthehet ne boten e vetmise: ne predispozicion hyjnor.

Tash themi se bota e vetmise eshte shanse per regenerim dhe ripertirje, prandaj per kete eshte thene se kjo eshte bote e vdekjes, sepse cdonjehere kur ne jete vijme ne udhekryq, ose kur nga ne kerkohet te ndalemi prej ndonje vepre te djallezuar, kemi shanse qe ta vdesim ne nderdije (pa ze tingellues); duke mos e lene egjren qe te ngrise koken, keshtu qe prej vet qenies sone levize dhe gjalleron fuqia e re qe te mundemi t'I permbahemi dinjitetit dhe karakterit te forte ne jete.

Kontrolla dhe lufta, luftetari dhe fitimtari, duke zvogeluar impulsin e pasioneve te percludshme, veset e pakontrolluara, tere shkallen e emocioneve te frikes, - te gjitha keto jane pasione ne boten e vetmise, aty ku jemi ne vet dhe, duke u kujdesur qe te mos e humbin kontrollen ne cilindo aspekt te jetes, me te vertete ne mbrojme pamjen tone per Cka dhe Pse jemi, reintegrojmë engjelloren ne entitetin e shpirtit tone dhe fitojme karakterin e forte ne mbrotjen e identitetit dhe te idealit te Abilit.

Koha ne rrotullim eshte predispozicion hyjnor. Njeriu mendon dhe e zbulon Zotin. Rrotullimi ushqen shpirtin me besim ne Zotin, ndersa trupin e ushtron per rezistence, per kohen ne te cilen duhet te luftoj, a kur eshte koha per Fat dhe Fitore? Ajo vjen ne vitin 2001 eshte koha dhe deri atehere, ajo dikton rrugen neper te cilen mund ta kryejme misionin e shenjte: "Zoti, vetedija dhe sakrifica, duke marre parasysh ketu edhe vdekjen, jane te vetmet rruge per ta shpetuar njeriun nga mekatet dhe eksploatimet e ndryshme". Nuk do te jete shume e dhembshme, ndersa pakez rende do te duket, sepse do te fitojme shume ne qofte se nuk abstenojme...

Dhe, ne fund te fundit, krejt ajo me te cilen nuk ballafaqohemi tash - DO TE BALLAFAQOHEMI NE VITIN 2001! Por atehere a e dini se ekziton nje pyetje e madhe: SI???

A DO TE JETE NE VITIN 2001 FUNDI I BOTES?

3

KRIPTOGRAFI ESHTË VITI 2001 DHE SHIFER ESHTË NUMRI 19..!

CKA I FLET KOHES SONE KEOPSI?

Njohesit e sekreteve astrologjike dhe konstruktoret e piramidave arriten t'i mashtrojne si racionalistet ashtu edhe mistiket, te cilet me shekuj u konfrontuan para madheshtive te permendoreve te varrimit ne bregoren e Gizes. Teoria kabalistike ka dhene kalendar komplet te njerezise, transkriptuar sipas mases dhe numrave neper korridoret, dhomave dhe mureve. Lindja e Jezu Krishtit, fillimi i Luftes se Dyte noterore ose fundi I nje shekulli dhe fillimi I nje epoke te re, jane vetem disa prej profetizimeve qe I zbulon ky "gur biblik", permendorja e varrimit, te cilen Keopsi ia ka ndertuar vetes qe te behet i pavdekshem. Tradika mistiko - kabalistike denjesisht verteton se ne piramide eshte shenuar fati I njerezise. Guri filozofik I rruges profetike, metafora per bercikezen e piramides, e cila njesoj si edhe edhe te shenjteria gjindet I gdhendur ne nje pllake te gurit ne nje paradhome te varrit te Keopsit dhe ka gjeresine prej 25, 4264 m.m. Nese kryhen operacionet e llogarise perkatese, fitohet, pra, duke filluar prej ketij numri, vlera tokesore e

zones polare e radiusit, duke u transformuar keshtu, sipas mendimeve te matemacienteve, ne mase me te persosur prej metrit. Ka te ngjare se eshte fjala per lojen e rastit, ngase disa teori vertetojne se kjo mund te jete fryt I jashtezakonshem I studimeve dhe njohjeve astronomike te dijetareve te Egjiptit. Shume e kane mohuar teorine e Carls Piacija, I cili duke vazhduar hulumtimet e paraardhesit te tij Tejlora, konkludon se bercikeza e piramides dhe nje inc anglez (e dymbedhjeta pute:2,3 cm) puthiten me kohen e zgjatjes se vitit, nese merren ne considerate ngjarjet e medha historike te ardhura ne lidhje me masen e njeshit ne korridore. Piacoja ne ato korridore e lexoi tere historine e gjinise njerezore dhe nje rend te profetizmit: kalendari I paraqitur si keops, I cili perfshin periudhen kohore prej gjashte mije vjeteve.

Profetizimet e kabalisteve

Ne fund te daljes se korridorit gjindet data e "kryqezimit" te Jezu Krishtit ne kryq, ndoshta te Jehudhes, e shenuar me distance prej 30 bercikeza dhe 1/4 prej dates se lindjes se tij. A eshte ngritur Jezu Krishti kur I ka pasur (30) tridhjete vjet e tre muaj? Lika ne Evangjelen e tij thote:"Jezu Krishti ka pasur tridhjete vjet kur ka filluar misionin e tij". Sistemi kabalistic I korridoreve dhe dhoma e mbretreshes, te veshteruara bashkerisht, nenkupton periudhen, te cilen kronologjia e piramides vendoset ne kohen ndermjet 25 dhe 26 te janarit 1844 dhe 2 gushtit te vitit 1909. Ndersa viti 1944, per disa, do te thote ore vendimtare ne kohen e emancipimit te popullit israile dhe ore e lige ne ndarjen e trete te tokave te pasardhesve te ilireve ne dy shtete me regjime ortokse sllavo-bizantine. Ne kete periudhe, prej rrjedhes se te ciles vjen deri te forcimi dhe fuqia ekonomike e shume familjeve te israileve ne SHBA dhe ne Evrope dhe deri te sllavizimi I Shqiperise politike, ndjekja e kosovareve me te keqen e vete shqiptareve dhe shfarosja e cameve myslimane ne Cameri si dhe emigrimi politik e ekonomik I shume shqiptareve ne Turqi, SSHBA dhe ne Evrope.

Mistiket vijen tjeter kabalistike ne gurin e piramides e shohin se datat kyce jane te caktuara ne nje menyre shume te qarte. Per shembull shpallja e Republikave te Bashkimit Sovjetik, me 18 janar te vitit 1910, eshte data e cila dy here lajmerohet ne kronologjine e piramides.

Do te ndalemi ne te vezhguarit e simbolizmave te shtate (7) gurezit e punuar te mureve te galleria e madhe, ne brendine e piramides. Po te

veshtrojme 28 minijatura te vizatuar te varreve, te cilat, dukshem, kane kuptime simbolike. Do te shohim se dominon edhe numri (7), tre milione shqiptare ne Shqiperi, dy ne Kosove, nje ne Maqedoni dhe nje million shqiptar aktiv ne bote, gjithsej (7) shtate milione, potencohet numri (7) shtate, kur edhe shqiptaret ne fillim te shekullit njezet e nje do te sundojne edhe luginen e Bardharit. Numri (7) shtate lajmerohet, edhe pse shihet diferenca ne lartesine e korridorëve, sic eshte diferenca ne origjinen e races ilire dhe slave, Kjo diference tani na con ne galeri, te popujt e medhenje te Evropes dhe botes dhe ne lartesine e vete galerise. Numri (7) shtate ka vleren e madhe simbolike, e cila vertetohet edhe ne relacione me librat tjera "profetike", sic eshte Apokalipsa evangjeliste e Johanit (eshte shenuar me entuziazem mistik), ne te cilin numri (7) shtate te nxenesi I ledhatuar I Jezu Krishtit perseritet shume here. Johani thote "Fatlum eshte ai qe lexon si dhe ata qe degjojne fjalet e ketij profeti dhe percillni permbajtjen e tyre, sepse dita e fundit eshte afer". A nuk puthitet ky parashikim me ate cka eshte shenuar ne piramiden e madhe, ne te cilen thuhet se fundi I epokes se korrucionit dhe kaosit do te jete ne vitin 2001?

Pergjigjia ne kete pyetje paraqet nje nder problemet me te medha per mistiket.

Paralelizmat kohore

Duke vazhduar hulumtimet dhe komentimet ne muret vijme neper datat te cilat perputhen me ngjarjet e epokes sone. Duke kaluar neper shume korridore arrijme gjer te nje korridor, I cili neve do te na coje gjer te dhoma e nentokes. Aty fillojme me te shpejte te leshohemi, cka e ka edhe kuptimin e vet simbolik. Ne dhomen e kaosit mistik shohim kuptimin e cmendurise, urretjen, negacionin, destrukcionin dhe shkaterrimin. Duke e mate kete dhome, fitohen rezultate plotesuese: 12 marsi I vitit 1913, cka pershtatet me kohen para Luftes se Dyte boterore dhe me konsolidimin e pavaresise se Shqiperise politike dhe me luftat e paepura te popullit shqiptar per bashkim kombetar, ose shkurti I vitit 1917 kur SHBA hyne ne luften. Data e neshkruar per paqe eshte e shenuar me datat tjera ne dhomen faraonike, 10 - 11 nentor te vitit 1918.

Mistiket kane konkluduar se ne kronologjine e Keopsit theksohen tre (3) periudha, e para, e cila fillon me 20 gusht 1931 e perfundon me 20 gusht 1938, paraqet kohen e pergatitjes per "provimin e madh", e dyta, prej 20 marsit 1938 deri me 18 shkurt te vitit 1946, eshte manifestim I te mires dhe te keqes; e treat, prej 18 shkurtit 1946 deri me 20 gusht 1953, thirret "gjkimi I gjyqit te madh". Periudha e pore perfshine (7) shtate vjete, 2555 dite, numer ky, kur te mblidhen shifrat prej te cilave perbehet, jep shumen 17, numer cka kupton "fillimin" ose "dedukimin". Kjo eshte koha kur Hitleri vjen ne pushtet dhe kur pergatitet Lufta e Dyte Boterore. Periudha e dyte perfshine (7) vjete dhe 182 dite. Nese ndalemi ne daten e cila shenon perfundimin e periudhes prej shtate vjeteve, arrijme te 20 gushti I vitit 1945 kur gjenerali Mek Artur pushton Japonin pas shkatrrimit te Hiroshimes dhe Nagasakit me bombe atomike. Periudha e trete gjithashtu zgjate 9&0 shtate vjete. Sipas disa komentimeve tjera, periudha prej 1953 deri 1960 eshte koha e perleshjeve te ndryshme politike, nga e cila do te lindin popuj te ri. Prej 1960 deri 1967 eshte periudha e paqes, e pastaj vijne shtate vjetet e ardhshem gjer ne vitin 1974, ku do te vijne ne shperthim shume demonstrata dhe luftra, perleshje guerile, sulme terroriste dhe, pergjithesisht, dhunime, perkunder revolucionit seksual te atyre viteve.(...)

Me 17 shtator te vitit 2001 perfundon kronologjia e piramides se Keopsit dhe atehere njerezimi, ose do te filloje jeten e re, ose plotesisht do te shkatërrohet. Fjalimi mijevjecar, i gurit magjik nga bregorja e Gizes, na le neve njerezve te sotshem lirine e plote te komtimit, perfytyrimit ose perfundimin e ardhmerise sone ne planetin toke.

A do te jete viti 2001 perfundimi I nje ciklusi dhe fillimi I nje epoke te re dhe a do ta pushtojne pasardhesit e ilireve Ballkanin dhe gjysmen e Evropes, ose ndoshta, do te zbrese kometa e zjarrte te na gjykoje, mbetet te shohim!?! Por, nje gje eshte e sigurte, kabla mistike ketu perfundon, duke e mbyllur mundesine profetike te piramides. Ajo qe ngjall kersherine e shqiptarit eshte se ne cilin kuptim deshifrohet ardhmeria e pasardhesve te ilireve dhe fillimi I shekullit njetzet e nje (XXI)!?

KRIPTOGRAFI

Erdha... dhe erdha dhe prape erdha...!?

Erdha ketu sot dhe erdha vetem per nje autobiografi qe une ty ta kam borxh. Takimi im sot me ty nuk eshte I pari. Pse une ne keto shtate vjete ne gjashte takime ne cdo ndarje me vete mbaja nje secret. Ky sot eshte takimi I shtate dhe I fundit.

Natyrisht, sot me shume se kurre, ti do qe t'i vendosh shifer dhe numer, ti do qe t'u ofrosh vizitoreve te shumte autobiografine time dhe te kalosh kohen me te!

Por jo! Ja, tani autobiografine time e ke te perbashket me gjithë ata mijera skllever dhe je bere permendore varrimi per sklleverit qe jane bere pluhur, qe kane punuar per ty gjate kohes kur kane qene te gjalle, qe do te duhej ta bejne ate edhe si te vdekur, por tani me shpirtin e tyre!

Ne c'kohe ka qene ky dhunim I shpirtit? Ne nje periudhe ndoshta ne nje roberi ne tjetren. Por jo ne varr. Ne permendore. Dhe, me sa duket, vuajtje dhe pafuqi ishte pikerisht ajo cka ty te shtyri ne kete cmendi; ne ankthin e shkurter te lumturise katastrofale qe vetem ti qe vuan me shume e provon.

Provon cmendi dhe ankth ne pamundesi dhe vuan per jeten e tejtokesoreve. Vizaton shpirtin pas vdekjes ne gur dhe deshiron te arrish lumturine perfundimtare me nje kercim, me nje salto mortale, nje shpirt te mjere e injorant qe vetvetja yte tallet me Unin tend dhe me kercimet e pakapercyeshme ne jeten e tejtokesoreve me trupin e ballsamuar.

Ishte shpirti I lire I sklleverve qe braktisi trupin, dhembjen dhe epilepsine e tokes. Ai ndjeu brendine e qenies qe I fliste: Ti qe ne histori njeh sklleverine, torturen dhe vetem varret e Keopsit, te Kefrenit dhe te Monkarenes ne shqip I emerton, e me tutje edhe gjashte varre te tjera me te vogla, te femijeve te faroneve, e ku eshte varri I paemertuar, ku eshte gropa e madhe e varrimit kolektiv dhe ne c'vend pushojne trupat e mijera sklleverve, te cilat me urdherin e faronit jane varrosur aty prane?

Piramida ne bregoren e Gizes. Per shpirtin ne trupin ne trupin e qelbur te tragjedise moderne, per ty, per vizitorin ne histori, por jo per sklleverit qe kane bartur shtateqind milione shkembinj nga Asuani per te ndertuar permendoret e varrimit ne Kajro. Me lumturine e veshur nga shkëlqimi I Zotit ne Berzah, ne ato nente piramida ata shohin tjetër gje. Aty eshte gjaku, mishi, djersa, mbytja; tortura e sklleverise. Dicka I kujton, dicka I bene te aferta ato nente varre, kapercimi I shkalleve dhe sa me ne drite dojne qe te ngjiten e te dalin aq me me force para Zotit, rrenjet e kokefortesise per liri I paskan mberthyer thelle ne toke, Brenda ne ate qe eshte dhome e poshtme, qe eshte ne erresire, qe eshte thelle - thelle ne te keqen. Aty ku eshte lumturia e endrres: LIRIA

Shih si thuhet liri ne varrin e paemertuar, me vend e emer, shih kete risi, endrren time te panenshtruar. Gjithcka qe shikoj, kudo shoh vetem shpirta te skelleverve dhe jane te lire vetem ne hapesirat e tejtokesoreve. Vertete! Sa do te desha qe liria e tyre te quhej e"e vertete" ose "toke" ose "parajse; per fat te keq ata kane vetem endrren: te rrojne me shpirtin e veshur nga drita e artit te Zotit sa me gjate ne nje mireqenie amshimi!

Ai qe percjelli gjashte takimet dhe qe eshte present edhe ne takimin e shtate dhe te fundit, asgje s'mund dhe sa me xhasus ne veprimtari do qe te behete e te me kap aq me I dobet behet ne shpirt qe s'ben edhe ai te shikoj aty ku shoh une. Ai deshiron te ngjalle ata cast, por ai nuk I vjen. Si peshku ithirur prej detit ne seancen e peshkatarit qe s'afrohet. Per ta ndjelle duhet nje reinkarnim I shpirtit ne trupin e tij. Cili shpirt feniks mund te reinkarnohet ne trupin e qelbur? Asnje...! Por gjithnje, a jam I obliguar te mendoj per xhasusin?

Pafajesi dhe harrese eshte kujtesa, nje rikthim dhe rifillim, nje berthame, nje epigjeze qe vetrrotullohet, nje trup I ri dhe do te behet shpirt qe pergatitet per lufte, e jo per metamorfoze. Ai njeh vetem Fitore, e jo paqen servile! Ai e prët zerin e Fatit, vitin 2001!?

Vetem shpirti qe, ne paqen servile, nuk dorezohet eshte feniks, eshte I thirur prej mediumit ne seancen e spiritizimit qe lidh brendine e qenies njeri me tejtokesoret, me shpirtat e e sklleverve qe lundrojne te lire ne Berzah? Kush e di se cka eshte Berzah? Kush...

Na thote te pranojme paqen servile, dhe raca ime duhet ta aprovoje kete dëshire te Keopsit, permes klanit te metamorfozes! Hapni syte se ju piu e zeza po t'I degjonit keta te fundit, po te votonit keto trupa te qelbur! Ju nuk e dini se vetem kete gabim Zoti kurre nuk do t'ua fale ne Berzah!

Kriptografi eshte viti 2001 dhe shifer eshte numri 19..! Kete shifer po ju jap: ne Berzah shpirtrat e sklleverve shkruajne: 1999 shqip! Mbi shkrim s'ka gje me te madhe se une. Une jam lapsi zbulues I Zotit. Dhe une largova mbi toke brenge e shpirtit dhe e zevendesova ate me celesin magjik - JETE. Dhe me thane: u ngrite mbi vdekjen - ti qe vdekjen tone ne sklleveri s'pranove. Vetem keshtu mund te meditosh ne spiritizim dhe jeta yte eshte qellim qe ka kuptim dhe vlere vetem me fjalen:LIRI, dhe se ti, pa dyshim, do te kesh gjakun qe shkruan: Fat dhe Fitore! Dhe gjaku eshte shpirt dhe shpirti eshte klithma e endrres qe po mbijeton dhembjen mbi varrin e paemertuar, me vend e emer: (.....)

UMMETI NE LUFTE KUNDER METAMORFOZES SE PUTHADOREVE

4

QOFTE DENIMI JUAJ FAT DHE FITORE

Kur jane te kunderta pikepamjet e dy paleve dhe kur, nga ana tjeter, qe te dy palet s'jane te zotet te dalin nga gjendja e veshtire se ku kane rene, atehere puna mund te shkoj keq e me keq e te perfundoj ne katastrofe...- ne mos I shpetofte ndonje fat I papritur. Por nje fat I tille ende nuk po shfaqej.

Pas perpjekjeve dhe investimeve tona ne politike ka mbete nje berthame dhe ka nje mbret te fuqishem, nje te urte te pakapshem per shqisat, - ai eshte Fat. Banon ne kodin gjenetik te popullit shqiptar, eshte rinia jone

qe nuk duron roberine. Ajo do te lind nje Fat dhe ai do te flet dhe do te shkruan Fitoren shqip.

Lufta karrieriste ne PPD ishte rezultat I shpirtrave te infektuar me veremlinjte e kuq dhe nje kohe tranzicioni... Ajo ishte semundje dhe nje mesim I madh; fituam denimin me 65 vjet burg ne Idrizove. Perfunduar ne burg per ta zbuluar Fatin e ardhmerise. Dhe kjo s'eshte cmendi - pse ne cdo cmendi, thote Nice, ka nje arsye! Ata qe shqiptuan denimin zbuluan vetveten se jane shqiptues te katastrofes, ndersa ata I denuan keta njerez me bindje se do t'I shpetonin katastrofes; keshtu ushqyen urretjen dhe urretja eshte cmendi qe banon ne trurin e atyre qe bertasin: "site vo zatvor". Por kjo cmendi, pa dyshim, do te vdes ne burgun e Bardhovces.

Ai tha: "Nuk me dhemb krahu - me dhemb shpirti" dhe eshte krenar per kete fjale dhe per denimin me burg. Por gjeja me e madhe - te cilen ju nuk do ta besoni - eshte Fati juaj dhe koha e cudirave te medha; ajo s'duron denimin me 65 vjet burg, por vepron me shpejte se ata qe nrehin kurthe per njerezit e njeres pale, e keta quhen shtet vasalesh dhe s'dine si do te quhen ne ardhmeri - pse ne katastrofe s'ka ardhmeri. Vertete, ky zbulim tregon fundin e botes! Vertete, katastrofa te kujton vitin 2001 - rrenimin e Piramides se Keopsit!

Qofte denimi juaj Fat dhe Fitore!

PPD dhe PPD! Ju dua me gjithe shpirt, isha dhe jam nga midisi I juaj. Por une jam edhe "armiku" juaj me I madh. Atehere mendimi im eshte: Uni. Ai edhe ne katastrofe mendon: Fitore. Ai eshte vetem mendim: Vetvetja. Dhe vetvetja jam Une. Lermenit t'u them te verteten!

E njoh xhelozine dhe urretjen e shpirtit tuaj. Nuk jeni aq te shenjte sa te mos pranoni xhelozine dhe urretjen. Nje jahudi eshte xheloz sa eshte xheloz nje shqiptar. Xhelozia ne shpirtin e nje jahudie eshte lufte dhe ajo prejjudikon te urrehen te gjithe njerezit, por jo edhe ata qe quhen jahudi. Per dallim nga kjo, xhelozia ne shpirtin e nje shqiptari eshte avanture dhe ajo prejjudikon te fetishizohen te gjithe pushtuesit per

shkak te zilise qe ushqen ai kunder cdo udheheqesi qe quhet shqiptar. Une ju njoh mire - pse e njoh veteveten.

Me flete dhe do t'ju flase koha:"Ju xhelozoni dhe urreni njerezit qe shqiptuan denime, qe rrezuan xhami, qe venduan kryqa dhe qe thone:"rushite sve albansko". Keta duhet te jene preokupimi dhe problemi I juaj; xhelozia dhe urretja! "Sy per sy dhe gjak per gjak!"

Ah, sikur te isha une I zoti dhe shqiptareve qe mirren me politike t'ua mbushja mendjet qe ata te mos mirren me shpifje dhe etiketa, me pune te kota, por ta ruanin me aq xhelozie njeri - tjetrin saqe, me gjitha ato ambicje per karriere, nuk do ta kishin te veshtire luften, madje ata do te ishin bartesit kryesor te perspectives ne Ballkan, do te flisnin me pak fjale dhe me shume pune frytdhenese, do te kishin me shume pengesa te njemendta sesa te kota...

Por tani qe mua me dukej sikur koha me pyeste - te pakten me ngjarjet qe I hudhte parreshtur - se cfare kam ndermend te bej - une nuk isha aspak ne gjendje te mendoj largimin.

Rremuja e percarjes dhe humbja e beses dhe perzemersise midis njerezve ne PPD me benin te mendoja se kishte ardhur koha te largohem, te levize, te ik dhe pikerisht para muajit te madherueshem te Ramazanit. Ndoshta e konceptoja largimin pak sa me ftohtesi nga arsyeja se dy vjet te tere isha I dashuruar ne poezi mistike e prandaj e ndieja nje lodhje ne shpirtin tim.

Sado e koklavitur qe paraqitej ceshtja, une vazhdoja te enderroj per Fatin e ardhmerise, dhe tere pasojat e shkaktuara nga poezia mistike, qe aludonte: luften dhe rezistencen e vazhdueshme, e jo metamorfozen dhe perkuljen ne Piramiden e keopsit, ishte nje ndjenje e fuqishme qe me freskonte ate enderr. Pavaresisht nga ajo qe une enderroja, dy jave para afrimit te muajit te Ramazanit, vendosa t'I pershkruaja edhe shkaqet pse une mendoja largimin, levizjen, ikjen, mbytjen, jeten, vdekjen dhe perseri jeten dhe, me ne fund, muzen e parathenies: Une dhe Zoti.

Keshtu une e vara shpresen ne kete hapesire, pasi ne oazen e metamorfozes se puthadoreve u perfercuan ndjenjat egocentriste dhe u instaluan paragjykimet mbi kauzen shqiptare qe prët Fitore. Qendrimi

steril ne kete oaze u prejudioj individeve qe punonin per fitore te mos ngulnin kembe, lere lufte... Ndoshta pse ishin lindur ne kohen qe, ne politike ose, sic I thane politikanet shqiptar, ne artin e te mundshmes, metamorfoza quheshte: Fitore. Ku ta dish? Ndoshta pse keshtu kerkon populli? S'do mend se populli qe eshte mesuar me se tepermi te fetishizojte, te kete besim me te dobet fetar dhe te manipulohet me lehte me "dhuratat" e Perbindeshit.

As' do te thote kjo: Politika konsiderohet si art I te mundshmes vetem qe te mos vendoset dhe te rroje gjate metamorfoza ne kete oaze? Te manipuloje mendja e shpirtrave te infektuar, per te tallur kauzen shqiptare. Ose, te ndahen nga kauza shqiptare kur ajo prët Fitore, vitin 2001, do te thote te ngazellehen me "dhuratat" e Keopsit ne odat dhe elegjite shqiptare.

Gjithe keto metamorfoza te puthadoreve merr persiper shpirti, qe me pahiri jeton ne roberi, dhe si kengur, qe ruan foshnjen ne bark, kercen dhe I drejtohet jetes me vetekenaqesi edhe ai ushqen berthamen e Fitores dhe foshnja ne kete prët Fat dhe Fitore ne ardhmeri!

Por ne metamorfozen me te madhe ndodh vetrrotullimi dhe ai zatete ne berthame, dhe foshnja ushqehet me leng berthamor dhe ndodh nderrimi I gjeneratave: ketu shpirti behet luan, do te mesoje luften, do te organizoje popullin dhe do te jete mbret I Fatit te vet. Ketu ai kerkon fronin e Keopsit te tij te fundit, do te armiqesohet me te dhe do ta fiton luften kunder shqiptuesve te katastrofes. Por deri atehere, a e dini sa te veshtire do ta keni ne jete?

Qofte veshtiresia juaj Fat ne vitin 2001!

Jetoni pra jeten tuaj te shpirtit dhe te veprimit. E sa vlene nje thirrje e imanit ne jete? Cili eshte ai medioker qe deshiron te sjelle fitoren me kryqezimin e shpirtit tuaj ne jete? Veremlinjte e kuq ishin ata qe deshen te na roberojne shpirtin; kjo ishte cmendia e tyre - sikur mbi shpirt te ishte ngulur vete komunizmi! Shpesh mbi shpirt vendoset roberia - madje shpesh shpirti qendron mbi roberine. A nuk mjafton ky shembull per jeten tuaj te shpirtit dhe te veprimit?!

Larg nga veremlinjte e kuq!

Afer eshte viti 2001!

ENDERR PER TE NESERMEN

Ne shpirt e gjeta premtimin e Zotit dhe, permes endrres dhe ilhamit, shkrova se cka do te ndodh ne vitin 2001 dhe 2015; enderr dhe shpetim: Ngulmim per te zoteruar jo vetem cka eshte e jotja (apo per ne, gjithë cka eshte e shenuar ne (I)liri eshte e jona), eshte shenje pse jemi popull I zgjedhur; Ummet superior me dy fitore ne lufte: Fitore e lirise ne jete dhe Fitore e shpirtit ne amshim!

Kur'ani thote:

Ju jeni Ummet me I dobishem e superior, I ardhur per te miren e njerezve, te urdheroni per mire, te ndaloni nga veprat e keqija dhe te besoni Allahun..."Ali Imran 110"

Me te vertete, dikush mund te hidhet e te kundershtojë me zili dhe prepotence, cfare po zbuloj sot, dhe te "argumentojë" se ky premtim eshte ne endrren dhe ilhamin e nje njeriu, mirepo une ne enderr shoh Fat dhe Fitore dhe ilhami prej perpara denoncon me shkrim: Ne qofte se dikush do te hidhet e do t'I kundershton keto rreshta, ai do te ben lajka, do te futet ne klanin e metamorfozes, ndersa per arsye subjective Ummetin s'do ta beson e s'do te na lene te tjeret ta fusim ne funksion e ta bejme realitet te prekshem, ndoshta ne vete, me patriarkalitetin gjenetik te races, do ta leme ne embrion.

Zoti ne Kur'an thote:

*Nun, betohem ne Penden dhe ne ate cka shkruajne!
Ti, me dhuraten e Zotit tend, nuk je I cmendur!
Dhe se ti, pa dyshim do te kesh shperblim te panderprere!
Vertete, ti je ne shkalle te larte te moralit!
Me vone ti do te shohesh, e edhe ata do te shohin
Se cili prej jush eshte I cmendur?*

(Quhet:"Suretul Kalemi" - kaptina e Pendes. E zbritur ne Meke, pas sures El Alak, ajete 52)

Feja eshte ceshtje besimi. Po cila ishte feja e profetit te fundit, Muhamedit S.A.V.S.?

Feja "e Librit, e Peshoreve dhe Hekurit"

Me pende shkruhet Libri. Ali Sheriati thote:"Libri eshte symbol per kulturen, intelektualitetin dhe edukaten; Peshoret per barazine, te verteten dhe drejtesine dhe Hekuri per forcen materiale, sic eshte qyteterimi, industria, forcat e armatosura dhe fuqia individuale e shoqerore."

Ne kete kontekst Sheriati mbetet ne apelin se "Cdo here duhet ta mbrojme Librin dhe Hekurin me futjen e Peshoreve ne mesin e tyre. Peshoret e mbrojne Librin nga kundervajtja e Hekurit dhe nga mbisundimi I tij mbi Librin... Mirepo c'mund te bejne Libri dhe Peshoret pa Hekurin? Asgje! Sipas Frenksit ata do te jene "fjale te vdekura" te mbeshtjellura ne fletet e letres. Kur Libri dhe Peshoret vendosen njera prane tjetres, atehere vjen koha kur Hekuri duhet te behet gati t'I sherbeje Librit dhe t'I bindet Peshoreve. Urdheresa e versetit te Zotit, ne te cilen paraqiten keto fjale, eshte shume domethenese si edhe mjaft logjike:

Me te vertet, ne I kemi derguar pejgamberet me argumente te qarta dhe me ta u kemi dhene Librin dhe Peshoret, qe njerezit te veprojne drejte; kurse ne e kemi krijuar edhe Hekurin qe ne te ka tmerr te madh, por edhe dobi per njerezit dhe qe Zotit te deftoje ata qe ndihmojne besimin e Tij, dhe te derguarit e tij pa I pare. Me te vertete, Zoti eshte I fuqishem dhe I dobishem.

(Quhet:"Suretul Hadid" - kaptina e Hekurit. E zbritur ne Medine, pas sures Ez Zelzeletu, ajete: 29)

Por nese do te ndalemi ne termin Ummet, do ta shihni si nje shpetim te idealizuar qe kalon dy etapa, e para 2001 - 2008, sidomos per rastin tone specifik (me troje me shume jashte se Brenda), zgjidhja e ceshtjeve nacionale (tokesore apo popullsie) dhe supermaci bashkimi I trojeve

shqiptare ne nje Shtet, dhe e dyta 2008 - 2015, kur gjithë cka tjetër, sistemi qeverises, standardi ekonomik, aleatet, shkencat politike dhe shoqerore (arsimi, historia, kultura, etj.), sigurimi shteteror (kaptina e Pendes dhe ushtria (kaptina e Hekurit) etj., ne hartimin e nje ideje per Ummet, jane ne funksion te tij. Nuk duhet te ndodhe e kunderta: Ummeti ne funksion te sistemit per monopolizim ne tri fusha: politike, ekonomi dhe fe. Ne sherbim te races se kabilit: forca, paraja dhe feja.

Ne Kur'an (po ashtu edhe ne Bibel), forca, paraja dhe feja, sipas Sheriatit, paraqiten ne tri personazhe: Faraoni, si symbol I fuqise, Karuni, si symbol I pasurise dhe Balam Ba Ura, kleriket ose hoxhalleret, qe e monopolizojne fene! Per shembull, njeri grabit koken e masave, I dyti u vjedh xhepat, e I treti u peshperit ne vesh: Mos u merzit, vella! Qetesohu, neser Zoti do ta zgjedh problemin tend''. Keto tre simbole, deri ne rrezimin e Piramides se Keopsit, gjithmone do te luftojne me racen e Musas qe eshte nje njesi e vetme:

UMMET!

Ummeti me monopolizimin, dallojne pikerisht ne objektin qe kerkojne; I pari kerkon cka eshte Liber, Peshore dhe Hekur, dhe I dyti, cka eshte Liber dhe Hekur pa Peshore... Prandaj, forcat e reja Islame te vetemertuara apo te deklaruar per Ummet, duhet te marrin persiper misionin teper imediat, zgjimin e realitetit Islam te kudondodhur dhe berjen unike te tij.

A duhet ta paraqesim realitetin Islam ne syte e Evropes si googol dhe cmendi kur ai eshte I determinuar nga Zoti si dhurate ne qenien tone?

- Kemi humbur shume per te falur akoma! Nje komb qe nuk synon per nje enderr te hershme (qofte edhe pan(I)lirizem, per nje perspective, eshte I destinuar te deshtoje ne ardhmerine e tij.

Nje "Nene tereze" ia kemi dhuruar botes e nuk duam nje luks te tille sa te kthehemi ne Komb "Nene Tereze" me parimin "nese goditesh ne njeren faqe, kthe tjetren". Them keshtu, se nga klani I metamorfozes se politikaneve shqiptar ndihet nje lumturi qe nder shqiptaret "nuk ekzistojne ekekstremistet dhe militaristet, ata qe interesat kombetare

per Ummet duan t'I mbrojne me forcen e armeve" dhe bertasin, ne tipin e mbijeteses (me politiken e mentalitetit difensive), te mblidhen shqiptaret rreth sloganit per Evropen e Bashkuar!?

A duhet te vazhdojme ta konsiderojme veten ne prag te mbijeteses dhe te lumturohemi me te? Ekzistencen ne tipin e mbijeteses e qenien ne difensive apo anatemimin e bashkimit te trojeve shqiptare ne nje Shtet, pikerisht keto koncepte fatale qe kane mbrapshtuar e zbehur rrugen e ketij kombi, dominant ne Ballkan, t'I paraqitesh si argumente mbrojtese te metamorfozes ne politike e ta propagandosh kete tkurrje ose zhberje te kulluar, s'eshte gje tjeter vec diskreditim I Ummetit ne momente specifike te histories. Gjykimi joparimor dhe teper steril I vetkrenarise per qenien ne difensive, duhet te largohet nga kokat e ketyre puthadoreve "qe bejne politike", nese duan te mbeten shqiptare e jo marioneta me permbajtje metamorfozash te njepasnjeshme ne tru, e nese duan te mbetemi ne raportet komb - komb e jo komb superior (te tjeret) - komb vassal (ne). Atehere:

NE KUFIJTE E EVROPES SE BASHKUAR

ME SHQIPERINE E BASHKUAR!

A duhet te mburremi me poltiken ne mentalitet difensive dhe me largimin prej dhenies se pasurise per Ummet, ose; te jemi arrogant dhe te lavderohemi ne odat dhe elegjite shqiptare me paaftesite per te qene te medhenje dhe influencore? E shtroj kete pyetje, se kokat e merdhitura te metamorfozes, per te cilat po diskutoj, jane zbulim I Zotit ne Levhi Mahfudh. Zoti ne Kur'an thote:

Nuk ndodh asnje fatkeqesi ne toke e as ne trupin tuaj, e qe te mos jete ne shenime (liber - Levhi Mahfudh) para se te ngjaje ajo, e kjo per Zotin eshte lehte. Ashtu qe te mos deshproheni teper per ate qe u ka kaluar, e as te mos gezohi teper me ate qe Ai u ka dhene, pse Zoti nuk e do asnje arrogant qe u lavderohet te tjereve. Ata qe vete bejne koprraci dhe me koprraci keshillojne njerezit. E kush largohet prej dhenies, le ta dije se Zoti eshte I begatshem, I lavdishem. 22, 23, 24 El Hadide

Larg eshte ne afersi te shpirtit viti 2001!

Larg pse mburoja jone vrasese do te jete mungesa e eksperinces per Fitore. Marrja jone me vetveten do te behet fryt I percarjeve per humbje. Po mes nesh c'po ndodh? Idealet mund edhe te ngelen thjesht ideale per idealistet. Edhe ne mesin tone gjithmone mund te stimulohen disa monstra politikanesh te mplakur te cilet ne mungese te idealit per te luftuar behen mjeshtra te absurdit, te durimit per te "ekzistuar ne tipin e mbijeteses" dhe mund te jene ne qender te interesit te globit, por tash, jo me si factor politik, ekonomik, social apo nacional, por si thundrrina te rralla per kushtet e nje zjarri Havije, me laven mbi krye: DO TE HYNI NE ZJARRIN QE ESHTË ME NXEHTESI SHUME TE LARTE!

Mirepo, dalengadale do te tjetersohemi, do te largohemi nga fryma e qelbur e klanit te metamorfozes se politikanëve, do te mendojme qe te behemi me te kujdesshem e t'I qepim me sinqerisht kostumet e idealeve me litarin e Allahut, keshtu, ne kete menyre, do te behemi me te pergatitur ne sfidat e viteve 2001 dhe pas...

DO TE VIJE DHE SHUME AFER ESHTË KAPTINA E KRISMES!?

QOFSHIN SHTATE VJETE SA SHTATE DITE DHE SHTATEDHJETE VJET SA SHATE VJET!?

Po une, ne emer te Allahut dhe te shpreses sime, po ju kerkoj: Mos e perbuzni kurre Ummetion nga shpirti I juaj! Quajeni te shenjte shpresen tuaj per Ummet - pse UMMETI vete eshte I shenjte! Megjithe premtimin e Zotit cfare e gjeta nw shpirt dhe ilhamin cfare e kappa ne enderr dhe e shkrova ne leter.

METAFIZIKA E VETEKENAQESISE

5

I LUMI AI QE KA GJETUR RRUGEN E DREJTE!

(Kur'an)

NE FUNDIN E SHEKULLIT TE DREQIT

Une (ku) jam...?

Atje ku Iblisi ishte I perzere prej meshires se Zotit, fillon jeta e njeriut qe nuk ishte e tepert, atje fillon Fati dhe eshte dua e te roberuarit (qe eshte I lire ne vullnetin e Zotit), ajo thirrje e vetme dhe e pazevendesueshme, dhe eshte e vetme ne jeten e muminit, shtylle e fese dhe nur I qiejve dhe tokes.

Atje ku sundon Iblisi, fillon misioni imam qe eshte I shenjte, atje fillon te levize berthama qe vetrrotullohet per Fat e Fitore, ajo shprese e vetme dhe e fundit, eshte nje ne jeten e njeriut, e udhezuar ne vullnetin e Zotit; keshtu ajo nuk zoteron e aq me pak zoterohet, andaj bekuar qofte shpresa e nje imami ne token qe quhet (I)liri!

Por!!!...

Liria ne (I)liri, ne pamundesi qe te kontakton me Fatin dhe Fitoren, luften dhe paqen, gjindet ne udhekryq, ne momentin me te rende historic, ne dimrin e pranveres ne prill. Por kete s'duhet ta qani: I ben dem shpirtit. Ai do sherim dhe ilac I tij eshte lufta. Vetem ne lufte banon liria: Ne mbytjen e shekullit te dreqit!

Shekulli I dreqit e ka themelin ne nje hider qe nxjerri koken e fatkeqesive ne Versaj, dhe prerja e pare e kokes se hidres ka ndodhur ne Jajce. Dhe kjo prerje ishte mashtrim! Ata qe ne Jajce prene koken e hidres ishin perdhunues te (I)lirise. Po te ishin te paqes ne lufte, nuk do t'I copetonin tokat e fqiut. Vertet, kjo te kujton eliten e shekullit te dreqit. Vetem nje histori: ajo me dy kryqezime, ne vitin 1919 dhe 1943, qe ka rrezatuar per zurretin (I)lir gjithmon fatkeqesi.

Ky shekull ishte tamam perdhunim deri ne fund, pasi beni pune te terbuar dhe shqetesim, pasi ia theu vete koken shpirtit te hidres, me nje

prerje te pergjysmuar ne vitin 1991, dhe kjo prerje, ne vend te trashegimise se rendomte, pjelli gabimisht nje hybrid, e ky sot quhet shtet, "me iftohti nder te gjithë perbindeshat e ftohte", thote Nice. Pasi ky shtet (dhe ai) mbeti me nje gjysmenjohje artificiale, me nje miniforce te cilen e posedon, e harron se force, pati edhe hidra por s'pati arsye, mendje per te menduar.

Vertet, kjo gjysmeprerje qe tregon vullnetin e vdekjes, qe njihet si kryqezim I trete dhe do te mbetet I fundit, te kallzon se ne pushtet jane instaluar po ata qe dje ishin ne eliten e shekullit te dreqit. Vetem me nje ndryshim: ata vendosen trupin (pa koke) aty ku nuk banon shpirti I tyre. Ne fillimin e shekullit te engjellit.

Por, ky shtet, me kete ftohtesi, qe eshte vullnet I nje grupi apo shtrese njerezish, qe ne prerjen e trete eshte hibridizuar, nuk ka mendje e as arsye; eshte pjelle e hidres. E deri nuk I posedon keto atehere nuk eshte I lire. E kur vete nuk eshte I lire dhe nuk ka liri si mund t'u jape liri ne (I)liri.

NE PRITJEN E SHEKULLIT TE ENGJELLIT

Pse (jam) shenje e ideologjise

Nje xhami e plakur ne token e vet, ne nisjen e vet te re ne (I)liri, me dhimbjen e vet ne pritjen e shekullit te engjellit. Nje histori e nje pritje, shume dreqer e nje njeri, nje njeri e nje popull, nje femije e nje Fat ne bote.

Pleqni dhe rini edhe foshnjeri edhe fat edhe Fitore ne (I)liri. Ne jete, ne paqe, ne lumturi, s'vdesin, rriten, piqen, s'tuten, s'bejne be: ne zyre, ne karrike, ne kravate, ne shallvare, ne mjekerr, ben ky e s'ben ai, hane e pine e rrine ne varferi, nuk ngucen: ne Cerove, ne Dizhon, ne Gazibabe, ne "parajs" pa rras mbi krye, pa glas ne sy, larg karrikes, kravates dhe mjekrres . Vetem pse s'kane metamorfoze ne tru. Presin projekte vellazerimi grusht bashkimi ne rresht, betimin e Zotit ne Pende dhe

Hekur, duan liri pse jane te lire ne vullnetin e Zotit. Jane njerez, s'jane te tepert, jane popull qe heshtin ne pritje, punojne pa "of" ne shpirt, lindin dhe presin nje drite, nje Nur!

Jam (une) dhe vije nga masat, tufat, safat dhe jam une rob I Zotit ne sherbim te Zotit, ne kerkimte lirise ne jete, dhe jo te nje njeri, te nje klani "tan ta ra manta", grupi apo shtrese, ne ferr pa drite ne fytyre, pa krenari ne ball. Larg (dua te jem) prej dreqerve, veremlinjeve, qelusheve, beslaguneve lkuraneve, horrave, larg kamxhikut dhe ferrit, jetes perverse dhe veseve hipokrite, larg kameres, metamorfozes, mutmedaljes, peshtymes, fikes, larg ne Mal (Turi Sina) me Musane. Jam ne Mal qe Musa te mbroje Musane dhe Musa do te ndihmoje Musane ne rrezimin e Piramides se keopsit. Larg ne koncentrim, ne sofer me Isane, gdhendi gurin e shpirtit ne vetmi. Larg ne shpellen (Hira) ne Mekke me Muhamedin. Jam ne bese qe Musa te besoje Muhamedin dhe Musa ta ngjalle Muhamedin dhe Musa te prese yjet e Musas ta kapen per litarin e Zotit; do te kthehem ne vendlindje, ne Fatin e Musas, ne zerin e Isas,

NE FITOREN E MUHAMEDIT!?!

PARKU I BEKUAR

Ora eshte 6:20 e mengjesit. Eshte e premte 11... (13) rebi ul evel 1413 hixhri). Eshte fundi I veres. Eshte Shkup. Eshte dita e dyte ne xhamine "Haxhi Jonus". Dhe, eshte jete. JETE! Per nje dite me te bukur dhe me te lumtur!

Zberthim midis kllapash

Analize. Bukuria banon ne kodin gjenetik te Fatit.

Lumturia prek ne gjakun e (I)lirise me Fitore.

Kthim ne Parkun e bekuar

Vetem e para dhe e fundit. Bota e deshmise. Pamedyshje, vetem ajo qe rri konstante ne pasqyren e universit, ne hapesirat e amsheshmerise. Edhe nje here nga thellesia e shpirtit, cuditerisht, si me histeri, me shpertheu zeri: "PO, DESHMOVA!"

Inspirim midis kllapash

**Diku ne amshueshmeri, me pyet: "A nuk jam Zoti yt?
"Po, deshmov!" Jeten me turbullira dhe gjakderdhje
e fitova**

**Ne toke e ne qiell cdo gje ma nenshtrove
Dhe emertimin e sendeve ma reflektove:
Ky engjelli,
Ky djalli**

**Nga mekati levizen dashuria dhe urretja
E zurreti im perfituan Jeten dhe vdekjen
Ne parajs
Ne ferr**

**Burim e kam Kur'anin - Fe ekam Islamin
O Zot! Vetem Ty te adhuroj dhe vetem Ty
Te kerkoje ndihme! O Zot!
Ky eshte emer I vulosur
Ne Zemer.**

Shpirti pas shtatedhjete mije perdeve me tha:

- **Une ty ta dhash ate qe me se tepermi e deshirove ti vete, ti dhe ti, ta dhash zanafillen e cdo gjeje, berthamen e Peshores, e cila me nje prekje ne matje ty ta ngjyrosi jeten dhe t'I mesoje te gjitha akademite e botes dhe me ato dituri ti dp t'I sherbesh popullit, per te cilin je betuar se ne emrin e Zotit do ta shkrish cdo qelize te trupit dhe te mendjes tende.**

Pagezim ne TA HA

Suretu Ta Ha. Adash I kujt jam? Siaps ibn Abasit shkronjat Ta Ha ne kaptinen e 20 te Kur'anit jane thirrje: O njeri, apo: I lumi ai qe ka gjetur rrugen e drejte? Apo: o Musa, si adash I kujt je - zbathi pra kepuçet tua, se ti je, ne Gazibabe, ne Parkun e bekuar (Ta Ha - 9 A te ka arritur ty rrefimi per Musane?)

Shkele Parkune bekuar, o Musa. Ngadal dhe butesisht, njerezisht, zbathur, shkele dhe mos ua var veshin atyre te klanit te inkouzicionit ne Cairska 52. As atyre te tempullit ne kodren e Saat Kulles; mos ua nencmo punen dhe egoizmin e tyre, pasionet e verbera karrieriste, mortajen apo virusin e ambicieve te semura patologjike, mos thuaj "trekendeshi I Dervenit" dhe mos zbulo "gladiatoret" qe heqin vallen e Kabilit ne xhami, ne arenen e cirkut. Thirr: o byrokrate, o lidera, o efendilere, o bakllavamena... vetem nje armik e keni: ata e njohin armikun me mire se sa e njeh ti, o Musa. Vetem njeriu therret, kelthet, shqirret, bertet, dridhet, frikesohet, Flet. (Ta Ha - 46 Mos keni frike! - tha Zoti Jam une me ju...) Eshte e mundur per njekohe nje njeri te shnderrohet ne dysh dhe te gjindet ne dy vende. Omer hatabi ishte edhe ne mihrab edhe ne lufte. "Ruaju Halid... pas shpine e ke armikun!" Ruaju dhe pergatitu rini... pas shpine ke shtrengaten ballaknike! Ne fund te shekullit te dreqit!

Rebelim midis kllapash

Pende e Hekur, ne mes tyre Peshore (57:25) ne Kur'an, shkrim e pune, uje e buke, enderr e gjum: I lire. Por kujt t'I kalzosh?

Tashti rrefe muzen tende, tredh fjale edhe nje here, kallzoju I perpikte ne ballafaqim, ne mendjen e lire. Paguaj cmimin e lirise e lidhu te rebelimi yt. Njeriu eshte forca e njeriu eshte gur pertej guri I kohes I drites I shkendijes ne rebelim te pritjes per bindje te duress ne skllaveri.

Me te drejte Nice ne Peshore thote:"Rebelimi - ky eshte emer I superioritetit per nje skllav".

**Superioriteti juaj qofte bindja!
Qofte komanda juaj bindje e zbatim!"**

Kthim ne Parkun e Bekuar

Shkele Parkun e bekuar, o Musa. Thirr: o vellezer, o motra! Foleja juaj eshte ne vatren e (I)lirise. Ne pritjen e shekullit te engjellit!

Zberthim midis kllapash

Gjate kohes se vetmise ushqehu me mendime deri sa te cmendesh: ka ende libra te gjenive te botes. Ose capraisu cdo nate erresirave neper klube: Bum. Kerce me kembe e dridhu me koke. Thirr rraspija e shtriga ne zjarrin e dreqit. Ose shkerdhe cdo rraspi sylarme neper shtepi publike. Dhe perfito orgazem s'e mbete pa orgazem ne Atdhe. C'te duhet ty shtetesia? Nuse te bardha te Rusise e passport belg e cek e sllovak e cka e gjithcka I ke ne Evrope.

Zingjir ari edhe argjendi ne qafe e bylyzyk dores e ne gisht unaz e ne vesh vath e emri yt mut me lule azilant. Vjedh ose nuk je vjedhes nga shaneret farmerkat e vjedhura "Levis" firmosen ne byth. Zi e me zi ne burg. Pas grilave.

Fundi s'eshte hapsane: ka ende me keq e mbi hapsane ne ankth Brenda kater mureve I shkaperderdhur ne mendime. Fut hashish per sherim ne cigare. Nostalgjia te kap edhe me shume, shnderrohet ne semundje. Kane mbaruar cigaret, kane marr fund nostalgjite. Ne strehe e ne skute I fryn folise. Gishti I madh dhe ai tregues futen dhe zgjerojne birat e hundes. Vjen helmi I bardh. Provon sprice ne qenef. Venet e gjakut jane verenik dhe trupi pleh. Gjaku eshte I verdhe dhe shpirti I shkerdhym. E fundi eshte vdekje ne Evrope. Ne side!

Kthim ne Parkun e bekuar

Shkele Parkun e bekuar - Gazibaben - o Musa! Pasuria dhe placka e luftes eshte vetem e Zotit. E imja eshte vetem nijeti. Qellimi: vepra e mire apo e keqe.

Denoncim m idis kllapash

Nuk jam artist ne teatrin e artit absurd. Perballe realitetit absurd te nje auditori. Subjekt e molle sherri ne Cairska 52. jam ne pritje te shekullit te engjellit. Por te kujtohet skena duke argetuar prane zjarrit e dreqer e qelushe e xhuxh maxhuxha e nuse e zana e fustana perqafohen nga dashuria per ta ndjelle qefin per puthje te lustrave ne fytyre.

Vertet, te kujtohet nje zagarice e dy klysh te vegjel. Nje mushke e nje gomar. Lehin e pallin. Ne radio dikush e vodhi mikrofoni. Ne program askush nuk e vodhi skemen. Pati mjaft mbledhje. Ne radio erdhi ne shprehje shundi. Nje pucerr e trupit qeshet e gilicet kur e kafshon miza e prek skrraja I duartroket breshka: "...hajde moj dashnie..."

Shyqyr Zotit qe nuk jam puthador dhe filistin ne skene, bretkoce ne radio, papagall kravate ne TV, horr-morr ne studio qe fshin hundet me mindil, skelet-skrraje me luledielli ne kafke I "madh" ne dije e ilm e dhenderr terllajki e referent I zyres se pleshtave ne karrike. Nje kaqurrel e veremlij me infarct ne zemer dhe me gjyzlyk ne sy I mbeshtetur ne karrike. Kembe mbi kembe mbi tavoline. Cigare, tym, pordhe, gaz e piskame. Mizat mblidhen rreth tij ne qark e hedhin valle "zeee-zeee" si ne vaten e mutit. E cka eshte me e keqja, do te kene kuj t'ia hudhin fajin per pordhen e ketij gazi te shkruar ne absurd.

Shyqyr Zotit qe nuk jam aty, I shame e I peshtyme. Nje redaksi e nje njeri, anonim me shume emra ne shume shkrime. Nje Hene e nje gazette, Zik - zake pol(e)tike. Ne focus. Analize. Omnibus. Timon dore te betemit e te laknaxhise se pushtetit.

Flaka eshte Hene e Hena eshte Flake. Gazete. Vije. Trekendesh. Draper dhe cekan. Nje platforme. Yll. Nje basem e kuqe e nje lule e verdhe. E vyshkur. Ra ne fe. Prek ne Hene. Futet ne Omnibus. Dy perlake te Flakes u miqesuan me nje gomar te Henes. Ky I fundit nuk palle me. E te paret e kan marr lejen e fronit te Reisit. Ne Giza te tre bashke u kacavirren edhe ne majen e Piramide, te shkathtit majmune. Te dehur nga tymi I duhanit te zim puthen me byth kalldermet e Fejshavit ne Khan Halil.

Ujku sqimen s'e nderron e zakonin e harron. Mos u huto, Qabe. Ti je fort e lashte e themeli yt ne toke me uje zem-zem s'e bluan dot kete lloj drithi.

Kthim ne Parkun e bekuar

Shkele Parkun e bekuar - Gazibaben - o Musa. Vullnet dhe deshire. Po. Une jam imam. Frike. Pergjegjesi. (El Isra - 71 Ate dite kur te therrasim tere njerezit me gjithë prijesit e tyre...) Si dp t'I dale Zotit perpara dhe me cka, me ndergjegje te pastert, me sinqeritet te forte, me moral Islam, me pune, me angazhim, me lufte, me flijim - te gjitha keto kane si qellim vleren e imamit, por pak jane ata qe perpiqen t'I posedojne si attribute te misheruara ne jeten e tyre te perditshme. Si... si dhe me cka, me vend pune, sic thone papagallet e inkouzicionit... ke sigurim social dhe ke rroge... (nje here ne muaj 70 DM). Apo, sic thone ndryshe, njerezit vdesin, dasmat me dafrunga, kane e pret peshqeshe te mira. Tash e ke edhe muajin e mevludit. Po, gjithashtu, ka edhe hatme edhe jasina. Krejt kjo eshte detyre e "shenjte"...

Fillim midis kllapash

Ne "Haxhi Jonus" hudha gjak ne berthame. Pleshtat, qelushet, koketulet, qoset, zhuganet e inkouzicionit me rane ne pusi... Ju ika e vajta ne Shqiperi!

Isha ne mal ne nje fshat rahat imam. Ne nje nahi ku u doxh xhami ne Cuperli. Ne nje vend ku shtepise I thone "doma" dhe mesuesit "uqitell"!

Mbylle corapen ne dac bej vegza: eshte krejt njelloj. Diku imamin e kane denuar!

Ia marrcin te keqijat.

PIRAMIDA E DASHURISE

6

DITARI ESHTË DHEMBSHURIA. E FORTE SI GURI DHE E FTOHTE SI AKULLI. NE LEXIMIN KU RRI KUJTESA. QE PREKU KALIMTHI ZEMREN E NJE SHTRIGE.

PIRAMIDA E DASHURISE

Ajo kishte hyre ne dhome dhe po shpalonte nje nga nje pjeset e jetes se Agron Gjinit. Perjashta, ajri qe I fresket; toka, e vaditur nga shiu I bute. Rete shperndaheshin. Ne horizontin e kuq qe dukej prej dritares se dhomes gershetoheshin dy kontraste, duke I leshuar vend nje kompromisi.

Ajo nisi te lexonte pjesen e pare...

ETHE BEHARI

Eshte pranvere. Duke ecur ne udhezen e gjate qe gjendet ne anen e majte nga zemra e Ceroves, nuk je ne gjendje te dallosh nese shtepite jane prej lloci, prej tullave me beton apo prej shtyllave me hekur, te cilat tashme I ka goditur mortaja e gershetimeve kohore...

Ne obirrin e ngushte te Mukes s'ke nga te sillesh, po "shtepia" e saj e plakur pa ndonje meremetim dhe mendimi se mund te gjallerohet ne themelet e te vjetres te futin, megjithate, ne shpirt nje ndjesi nostalgjie, tamam sikur te jete plan shatevjecar. Kete pershtypje ta perforcojne edhe me teper heshtjet e, here - here, edhe buzeqeshjet e saj te zakonshme.

Keshtu mendoja deri para do diteve dhe supozoja se ajo mund te kete kuptuar qellimin tim te paster, qe buron nga shpirti dhe zemra. Sa here qe kaloja ne udhen e gjate, permby ure, e takoja dhe menjehere valet e amshueshmerise ne perkdhelshmeri jehonin dhe piqeshin si ne dramen e Shekspirit.

Mukja e ka thene kushedi se sa here: "edhe ma kanda, edhe s'ma kanda" me Jo. Sic dihet, dic do te kete ndodhur, po nga shenjat qe kallzon e nga menyra se si e vjedh shikimin me bisht te syrit, kuptohet se ajo e ka nje grime shprese... Po, ka folene e vet dhe as qe do te degjoje kur asaj ndokush I flet keq per fraerin e saj...

"He, pelcitni... a keni se cka te me beni - une vendos per fatin tim e jo ju..." Kete e mendoja se mund ta kete thene Mukja perpara atyre qe ushqeheshin me marrezi te zakonshme dhe me shpifje te trilluara. Djallezite e ketilla, e dija se, nuk do ta Lenin te qete Mukjen andaj, kur qe ajo e semure, mbrothesia e dashurise me nxitin qe une asaj t'I shkruaj per plogeshtine e trupit dhe per rrenqethet e lekures, per trokitjet e dobeta te zemres dhe per imagjinate e mprehte te mendjes, per fijen nga filigrani I shpirtit dhe per frymemarrjen horizontale dhe vertikale te dhembshurise. Te gjitha keto, si duket (ishalla enderr), Mukjes nuk ia ngacmuan zemren. Nga ajo nuk mora asgje, as pergjigje me goje, as leter me shkrim e as me ze ne receptorin e telefonit! Pyes vetveten: valle, ku gjindet tani ajo? Pse nuk me lajmerohet...? A mos djallezite e atyre qe ishin te zene nga shurra e burgosen dashurine - Jo! Kete ata nuk mund ta bejne! Nuk kane fuqi! Por, nje gje eshte e vertete, dic do te kete ndodhur...

Pritjet e mia qene te akullta, si prekja e vdekjes. Zemra, me trokitjet e saj, pergjigjen priste. Ke vajton mendja qe eshte lodhur nga imagjinata e tepruar. Cdo gje perfytyrohej dhe horizonti nostalgjik po shkonte duke u bere gjithnje me I vreret, mbarsur me mendime se ajo eshte humbur dhe eshte tretur ne boten e hicit, ne boten pa ankth...

T'I kthehem kriterit te jetes, te kerkoj interesin apo ta kompensoj mosparaqitjen e Mukes me Driten nga bota e hicit ne boten e ficit. Ah! Sikur mos t'I kasha besuar atij fallxhiu qe me thoshte te mos kerkoj doren e Drites, siku mos t'u isha bindur fjaleve te tij:"Drita kerkon zeshkan", ndoshta, cdo gje (sot) do te ishte ndryshe.

Keshtu mund t'I kete ndodhur edhe Mukes qe, eshte normale, ndonje fallxhore t'ia kete thyer doren e djathte, t'ia kete zvogeluar shpirtin ne oborr te ngushte dhe t'ia kete shnderruar zemren ne shtepi te plakur. Ajo nuk ka faj sic nuk kam edhe une, kur them: medet si qenka mashtruar shpirti dhe zemra ime, si qenka magjepsur syri im... Cdo gje e saj paska qene e rreme dhe mashtruese, e mbeshtjelle dhe dinake, e mistershme. Si diti, ajo, aq bukur dhe me aq mjeshtri te lustroje vetveten. Cudi! Edhe pse, siapas Kantit, lustrimi ben pjese ne te shemtuaren. Nga fakti se Mukja duke mos kuptuar dhuntine e Zotit: dashurine, ose ndjenjen mbi te bukuren: lustrimim. Ajo keqperdori llojin e vet: femeroren. Me cka ndjenja mbi te madherishmen pesoi humbje katastrofale, te mos them fatale e te bij ne fatalizem, ne "kundershtim" me parimin tim:"Aty ku ben pjese vullneti dhe deshira e njeriut nuk eshte asgje e determinuar nga Zoti..." Ne relative...

Perkunder asaj qe Mukja beni lustrim ne drejtim te se shemtuares, ne brendine time emocionale krijohen iluzione te reja qe pershkohen me ETHE BEHARI per Driten ne boten e ficit. Fotografia e saj me del perpara e qeshur dhe e perzemert, qe nuk zemerohet, e celur dhe gojembel - lule behari, e perqafoj, e perkdhel me afsh deri, (sa me kujtohet...)!

Ajo qe u fut ne pjesen e pare dhe qe e njeh shume pak Agron Gjinin, asgje s'ben ne meditim dhe, si duket, s'ka kontroll mbi leximin qe ben ne ditar. Per shkak se lexon ne pjesen e dyte:

NE SIMFONINE E NGJYRAVE TE AURES

Cdo te shtune shkoja ne nje bufe, me shtate tavolina, ne 32m2. Ate bufe e zbukuronin cezmat e murit qe rrjedhnin uje Nili gjithnje. Vetem nje vrime e vogel rrinte e hapur ne kerthizen e tavanit. Kaltrina nga "Sahara city" ishte e ngarkuar nga pronari I bufese per t'u shpjeguar te interesuarve historine e piramides se famshme te Keopsit, me te madhes mrekulli te shtate mrekullive te botes, qe ne kohen e Muhamed Ali pashe Kavalles ishte thyer ne dysh. Aty, ne ate bufe, veshtrimet e para te Kaltrines, ato veshtrime me plot shpirt, ma kishin rrembyer Zemren. Sa here bisedoja me Kaltrinen I dhuroja nga nje trendafil. Shpesh I tregoja per Shkupin dhe per luginene e djathte te Bardharit. Ne mbremje largohesha, ose kur shtrengonte doren time, si random, per pershendetjen "mirupafshim", nuk di as vete se si futesha ne zonen e fuqishme te aures se saj magjepsese, qe pershkohej me plot e perplot ngjyrash te ndritshme.

Ne papirusin e bukur dhe te verdhe Drita e kishte vizituar portretin tim, me dy "M" te pafshira ne kujtese dhe te pashlyera ne jete, qe ta conin mallin e Getes dhe Sharlotes. Drita ishte nje shoqe, e cila me donte shume dhe ishte zotuar se, po qe se nuk me ben per vete, "do te bej vetvrasje". Por, papritmas - befas, me 17 shtator..., ajo vdic nga vdekja e ntyrshme, u shperngul ne kopshtin "Firdevs" pergjithmone. Diten kur ajo vdic une isha ne Gjeneve, ne bufene e "La Gare".

Pas dy vjeteve, kur u ktheva ne vendlindje, te kusheriri I saj m'u dha rasti ta shoh varrimin e saj ne videokasete, te shoh ate turme njerezish qe bartnin ne dore kofomen e te ndjere Drita per ne varrezat e qytetit ne "L'amour". Nga kjo pamje u pikelova aq shume sa pastaj mezi mblodha fuqine e endrres sime e, per here te fundit, t'I them: "Je suis conten de vous voir"!

Oh!... une... c'te bej... kur trupi I Drites ne imagjinateen time ka zene vend vetem si kufome qe rri shtrire mbi teneshir, e mbeshtjellur me qefine te bardhe, pa e pare une I mjeri fytyren e saj te bute. Ne auren qe me perthekonte, ngjyra e bardhe e qefinit e vajtonte lamtumiren e fundit per pafajesine dhe per dashurine e cilter te se ndjeres Drite, kurse ajo turme njerezish me grushta hedhnin llocin e kuqrrremte te "L'amour" mbi derrasat e forta, te cilat e kishin mbuluar per jete te amshueshme nje idil te pakurorezuar ne boten fenomenale te intrigave.

Ishte e premtë, kur une papirusin e bukur dhe te verdhe e kasha dorezuar si dhurate ne duar te Kaltrines, kurse ajo ne vend qe te gezohej se do te lirohej nga kafazi I zogjve, kur e takova te henen u binda se ajo frikesohej se do te vdiste nga vizatimi I Drites, qe ne te portreti im ishte ngjyrosur me vija te kuqe, qe ngjallnin ndjenjen e dashurise se madhe, drite e ngjyres se aures sime qe luftonte demonet dhe shpirtrat e mbrapshte ne Piramiden e Keopsit.

Po. Ajo tani ne duar ka enigmen time. Si do ta kuptoje? O Zot, qe shtate muaj po perpiqem ta zbuloj kete enigme, enigmen me nje ndjenje te vetme dhe asgje s'mund t'I perngjas endrres sime e te thote: Ajo nuk do ta kuptoje ndjenjen tende ne dashuri!?

Para disa javesh, veshja kemishen "avanti" me kravaten e kaltert dhe dola prej shtepise, si random, ne drejtim te bufese. Ate dite ngjyra e kaltert e krevates ne auren time tregonte qendrueshmeri dhe largpamesi, ma pastronte dhe ma qetesonte mendjen. Kisha pershtypjen e thelle se kjo ngjyre ne mua me shume perfaqesonte pamjen shpirterore, sesa ate materiale. Deri sa po pija sirup drethezash ne bufe, Kaltrina, qe ate dite ishte veshur me kostim ngjyre rubini, ne vend qe t'I sheroj plaget e mia, erdh dhe m'u ul afer dhe me foli me nje ton te vrazhdet: "Si mposhte ti ankthin e endrrave pa gjume, kur une ty nuk te dhasg asgje, kur une te thash vetem nje fjale: FLUTUR!?! Ti mua keshtu me ofendon, e kupton... apo jo?!

O Zot, tash e kuptova se paskam qene ne ethe, paskam enderruar se kot se koti, qe shtate muaj ne auren e ngjyrave te saj paska qene fshehur enigma ime, po zjarri I endrres sime, s'paska qene edhe I saj. Po. O Zot, tash e kuptova se ngjyra e rubinit ne zonen e aures ndonjehere reflekton edhe urretje te madhe, sic ishte I vrazhdet toni kaltrinor drejtuar zones se aures qe perthekonte trupin tim me ngjyrat e Ylberit.

Te nesermen, ne bufe, me personin G. po bisedoja per ate qe me kishte ndodhur dje, kur befaz u paraqit Kaltrina, qe isha veshur ne xhakete te bardhe, na pershendeti dhe shikimin tim, si zakonisht, e vodhi me bisht te syrit, duke me lene qe une te meditoj ne zonen e aures. Sakaq me ra ndermend se e bardha eshte e ngjyre e pastertise, e pafajesise, e cila shfrytezohet per ta rikthyer auren ne vendin e vet, kur ajo demtohet prej ndonje lendimi fizik, ose prej ndonje traume emocionale. O Zot,

falem, falem! Une zbulova celesin magjik - e ngrire paska qene zemra e saj locka e saj, ne mes te bufes, me shtate tavoline, ne 32m2.

Te premten tjetër, ne "Roxi", ishoqeruar nga personat Z. dhe G. vendosem te ulemi ne "Groopi", ku nuk ishte Kaltrina, kurse ajo edhe ne ate vend u paraqit me elanin - Lule, qe ishte e veshur me fanele te verdhe, na pershendeti dhe buzeqeshi, por kesaj radhe krejtesisht me nje pamje te re! O Zot vetmevete thash, edhe kjo m'u dasht! Nga fakti se e dija se ngjyra e verdhe eshte e ngjyre e natyres se femijerise, e cila nuk mund te dale ne krye me obligimet e te rriturve. Nese me maturi kjo ngjyre perdoret ne zonen e aures, atehere ajo mund te reproduktoje stimulim mental, kurse te personi I paafte shume lehte kapercen kufirin e palejueshem. O Zot, ke meshire dhe mbroje Kaltrinen, mos lejo qe ajo te bjere ne ndonje gracke, por bekoje dhe beje te lumtur ne nentor, ne ditet e flamurit kuq e zi!

...ne ditarin e Agron Gjinit, me germa te medha, ishte shkruar edhe nje poezi e shkurter, por me domethenie te madhe:

**GREMINE MUND TE JETE
MUZA E DASHURISE
FUND I KOBSEHEM
SIMFONI NGJYRASH
ME NJE EPIGRAM MBI VORR**

Ajo futet perseri ne dhome dhe lexon nje poezi te shkruar ne ditarine Agron Gjinit dhe po fillonte te pyeste: "Kush eshte Drita dhe kush eshte Kaltrina? C'eshte paraqitja me elanin - Lule dhe c'eshte dhoma 2001 ne Piramide?" Ajo s'kupton shkrimin e Agron Gjinit: "Disa personazhe nuk zbulohen kurre, vec kur krijohen me pare ne trurin e shkrimtarit"

DHOMA 2001 NE PIRAMIDE

Midis korridoreve dhe dhomes 2001

**Ne godinen e madhe te Piramides
Drite me shtate ngjyra te aures
Nje ndjenje qe te levize prej gjaku ne zemer**

**Shpirtit tend I ben barricade
Shpirtin tim e shqeteson**

**Une I kam shtate mije zemra
Dhe qe te gjitha rrahin per Ty
Midis korridoreve dhe dhomes 2001
Ne godinen e madhe te Piramides.**

**Simfonia e ngjyrave te aures te stolis me drite
Si zjarri hyjnor qe I ben drite Profetit
Ne luginen e shenjte Tuva**

**Korridoreve verej shume shifra
Dhe qe te gjitha deshifrojne
Rrugen e dashurise
Misterin e dhomes 2001
Jeten dhe vdekjen -
Lulen e amshimit**

"Po, ne te keqen: vdekjen!" - kelthiti Ajo me shpirt. "Si ka mundesi qe Agroni ta zbulon shpirtin tim?" Ajo, me shpalimin e ditarit, pa lejen e te zotit, tanime nuk e hetonte se kishte rene ne thellesine e grackes qe po e krijonte vet dhe prape lexon:

FALLI DHE KULMI I PIRAMIDES

Ajo, pasi thelle ishte future ne gracke, me nervozizem ballafaqohet me artin e letres. Me e nervozuar se kurre. Thelle ne kujtese mban fallin dhe permbysh filxhanin si ndonje kulle te fshehur. Qe bredh neper kozmos. Per te marre mendime, fjalet dhe endrrat formen e nje shtrige. Ajo thirret me telefon, lajmerohet dhe e gjen veten ne pjesen e trete. Ajo lexon:

Ne nje ene te bukur prej ornamenti egjiptian, qe ishte e shkruar edhe me heroglif faraonike, personi L. ktheu permbys filxhanin ne te cilin kasha pire kafe turku dhe, pa insistimin tim, deshironte te me qese fall me bisht. Pas pak, bashke me kotjen time te lehte ne gjumin e pasdrekes, zuri ta shikonte brendine e filxhanit dhe te me fliste per ate qe, sipas bindjes shterpe te saj, atyre diteve mua me preokuponte nate dhe dite. Po binte shi I bute perjashta dhe rete e shpejta e sollen terrine pasdrekes ne byrone turistike, qe ishte e rrethuar ne te kater anet me kulmet e kuqrrime te qeramikave, si ne qarshine e Bit Pazarit. Thua e prita nga personi L. nje fall me bisht nga ky filxhan, prej te cilit kuptova mentalitetin e dobet dhe sjelljen provokuese...(Oh! Rini, kah tutje?) Personi L. fliste ate qe e shikonte ne brendine e filxhanit dhe sa pika shiu qe sperkaten xhamine e dritares, po aq fjale, si me shigjete helmi, ajo gjuante ne ardhmerine per fatin, ndaj fatit dhe ne fatin tim. Por krejt nga ajo cka mua mund te me kujtohet permblidhet me pak rreshta:

"Ti, Agron, ke nje spirance. Nuk je edhe aq shume I lumtur. Dikush do qe Ty te te shoh ne levizje, por kjo spirance qe eshte kapur thelle ne det nuk ta mundeson dot. Koheve te fundit je duke e percjelle nje vajze, e dashurone shume, por nuk je I sigurte ne kete dashuri, ndoshta pse kjo dashuri per Ty eshte qorre, se ne filxhanin tend ka edhe size. Ja, ketu ke edhe nje godine shtatekateshe, ka filluar te priset, apokalipsa e kataklizmes se ketij "idili" te palindur do te kete vetem tmerr dhe fund te kobshem. Po, gjithashtu, ke nje germe me inicialin M dhe ke edhe nje aeroplan, do te shperngulesh, do te vije Brenda muajit nje lajm I mire, do te gezohesh dhe do te buzeqeshish me jeten, te cilen e ke idealizuar ne frymen platonike. Ky lajm I ri do ta materializojte jeten tende ne frymen e avanturave, do ta konkretizojte si figure shumeidilike ne boten fenomenale te intrigave. Ti, Agron, pergjithesisht, je njeri me energji dhe ambicie te medha".

Personin L. me nuk me dha rasti ta shoh me ne stilin dhelprak, kishte frike edhe te me afrohej, e lere te me qese fall senzacional ne filxhanin e rrumbullaket. Kurse personin M., per te cilen aludonte personi L., e shihja pothuajse per cdo dite, mirepo nuk deshiroja qe ajo te me shpjegoje per historine e "svinskit" te famshem te "Ebul Hulit", te cilit kane filluar t'I bien copat e gurezve te Asuanit. Te huajet (turistet) qe I

vinin per vizite piramides se famshme te Keopsit, rruges, ne Giza, hipur ne deve, e bekonin "Ebul Hulin" me embleme magjikeqe gjithsecili turiste embleme e kishte zemren me shigjete ne mes, prej te ciles pikonin shtate pika lotesh. Ky bekim dha shkas qe nga vashat e Haremit te perhapet me te madhe lajmi se te huajit jane ata qe ia sollen siden "Ebul Hulit" dhe andaj po I bien gurezit, edhe ate duke ia ngjitur per koce kete semundje vdekjepruresse ne pike te drakes ne shkretetire.

Edhe une e ndieja veten ne ate mes I huaj, njeri qe nuk e dija edhe vet se nga vija, nga Perendimi apo Lindja. Ky ishte shkaku kryesor qe nuk doja te me shpjegonte askush (e as personi M.) ne lidhje me historine e te kaluares se "famshme" te faraoneve. I huaj per arsye se nuk e shikoja me sy te mire Piramiden e Keopsit.

Cdonjehere ajo me shikonte kur une numeroja shkallet e Piramides, e pastaj buzeqeshte si bushter. Ne auren time, nga vala e nxehte e ajrit, vinte era e parfumeve kineze te nuseve te Mao Ce Dunit, me c'gje personi M., me floket e kuqrrreme dhe syte e shtriges si googol, mendonte se nje dite do t'I sjelle gjakut tim helmin e Sokratit e te me mbyt ne vend. Jo! Nuk mundesh... kurren e kures... nga fakti se ne vendin ku qendron Ti - une e quaj sketerre, bodrum me lloj-lloj felliqesirash... Por nuk kam mundur te paramendoj se karakteristika yte, pamja yte, zeri yt... (Ah! Zeri yt moj bushter)... do te mund shpejt dhe aq lehte te devijohen, te asimilohen prej nje vashe... ne Brizhit Bardo. Ti nuk do te jesh ne gjendje qe nje here te thuash ate qe me se tepermi e deshiron Toka yte. Ti nuk kupton dhe prape sillesh Brizhit Bardo. Ti vepron keshtu qe ne ty te ngrihet cdo ndjenje, qe pershkohet me shushuritje, dhembshuri dhe perkdhelje. Dhe ti prape s'kupton! Por...

Ne shenjen time tranzistojne planete te shumte dhe merhaba vjen lajm I ri, bashke me te edhe Jupiteri. Nisem te provoj fatin ne kulmin e Piramides, cilen vajze po e percillja dhe cilen po e dashuroja... Rruges shkalleve per ne kul I takoj te gjitha rastesisht dhe them: coincidence. Kaq. Kurse ne zemren e njeriut, sipas poetit, ka vend vetem per nje dashuri. E mua me vdic Drita dhe bashke me te shkoi edhe dashuria e saj. Vetem duke qeni I sinqerte ndaj saj une mund te ngjitem ne kulmin e Piramides, lartesia e se ciles eshte aq sa eshte lartesia e Tokes prej Diellit, vetem me perpjestime me te vogla. Ne kulmin e saj kur arrij ndez shkrepesen ose cakmakun (kujtimin), por nuk shoh qe vogelushja te

jete rritur dhe godina te jete prishur, nuk me nevojiten as size e as durbi, jam ne kulmin e Piramide. Dhe...

Shkruaj. Nuk ka frike vdekje kjo zverdhje. Nuk ka mure ku ankth. Nuk ka spirance qe mund ta beje te palevizshme anijen time. Hiri I saj nuk ka fuqi te shkrihet ne det. Anija ime po fashit lundrimin e vet pa erera. Ajo qe gjithcka enderron mori dashurine e Memedheut ne preher. Pikerisht...

Aty, ne kulmin e Piramides, u betova se do te ik nga Egjipti, nga Giza, nga Haremi dhe, ne fund, e luta Zotin qe as ne enderr te mos me sillet ngjyra e zeze e bodrumit, sketerres me plot e perplot felliqesira. O Zot, thash, falem, falem...! O Zot, tash kuptova se botekuptimi im eshte filigran I shpirtit qe shkelqen, e gjaku - lum I pandalshem arberor ne zemer. Ky gjak nuk guxon te perzihet me gjakun e vashave te Haremit qe sillen si kuqka, dhe per nje shpjegim te thjeshte te histories se faraoneve, pa fije turpi kerkojne zingjir ari nga te huajt (turistet) e Perendimit ose te Lindjes.

Ka nje vit qe ika nga Egjipti dhe gjysme vit qe me personin E. po komunikoj me ane te letrave, dhe cdohere ne fund I shkruaj: "Eja ne vendlindje, ne Shkupin tone te dashur se une Ty... (shqip)"

...ne ditarin e Agron Gjinit, me pika gjaku, ishte nenshkruar nje emanet:

**SHKUPI ESHTË LINDJA JOTE NE CEROVE
FEMIJERIA DHE LOJA JOTE NE DIZHON
RINIA DHE ARGETIMI YT NE SARAJ
DETYRA YTE E SHENJTE NE GAZIBABE
SHKUPI ESHTË SHPIRTI DHE GJAKU YT
QE NUK FALEN LEHTE**

*Ajo u ndal dhe mbeti ne pjesen e trete. Arti ne leter e mbyti. Ajo me xheloz
mbylli ditarin. Nata leshon erresiren ne horizont dhe ne shkrim mbetet
vetem nje kontrast, duke I leshuar vend nje poezie.*

**Nga dita ne dite ti do te thinjesh,
do te rudhesh,**

do te plakesh,
do te kuptosh vetem nje ndjenje,
nje enderr dhe koha s'humbet,
por mbetet kujtim vetem nje "M"
ne zemer
me shigjete ne mes!

EROSKOPI

7

**JU JENI ME ART TE SHKRIMIT
NE SHTRAT TE LEXIMIT**

EROSKOPI

Ne prekjen e pare

"Nje grime shprese..." e ka themelin ne nje enderr te pakurorezuar, ne nje dashuri qe lindi ne diten e Gjithesise, ne nje burim qe depertoj rrjedhshem ne brendine e shkrimit qe fliste shqip, dhe pershkrimi I endrres qe nga ajo grme e gjer ne vetrrotullim e nje dashuri ndoshta ne tjetren, paralajmeron mitin ose legjenden: "Diten e krijimit te botes". Kur Perendia u dha misione te dymbedhjete shenjave te zodiakut. Kur eshte afruar Peshorja, asaj I eshte thene:

"Ty Peshore do ta jap misionin qe gjithmone te jesh ne sherbim, qe permes teje njeriu te behet I vetedijshem per detyrat e veta dhe te mesoj pak me shume per frymen e bashkepunimit, si dhe te mbash ne shkrim ekuilibrin me veprim te trupit ne kontinuitetin e kohes. Ty per ate do te ve atje ku ka percarje, dhe perpjekjet e tua do te stimulohen me forcen e dashurise".

Ae dini ju se s'jam rastesisht Peshore?

Ky mit flet terthorazi Kur dhe Si gjen Peshorja kenaqesine e vet e qe gjithmone eshte rezultat I arsyes dhe mendjes se shendosh. Mendimi per kenaqesine eshte instrument I trupit dhe ikja nga politika nuk jam une: ne kerkimin e kohes se humbur. Koha e humbur gjithnje eshte dashuri dhe force qe mban ne jete vetekenaqesine per nje grime shprese... Gjithsecili njerim mendon per dashuri, kurse une ne nje dimmer fillova te shkruaj per dashuri...

Nje ikje e madhe ne kerkimin e kohes se humbur ishte perzier me nje ndjenje dashurie. Me kete ndodhi m'u be e qarte se dikush hapte befas nje perde, nje grime shprese, hapte nje Fat dhe m'u perfytyrua me nje q qartesi te habitshme nje enderr e prekjes ne shtrat. Ne ate enderr kishte me te vertete dicka interesant. Ajo prekje e embel, ku mund te gjeje patjeter vetem muze shkrimi poetik, raportin midis prekjes ne shtrat dhe dashurise ne enderr, midis reales ne seks dhe ireales ne shkrim. Me teper se e embel ajo ishte e jashtezakonshme, e vendosur ne shtratin e artit.

Prekja e pare e embel qe mua me zgjon ne tru nje lloj mekanizmi kerkues, qe ne brez rrethor ishte dashuria; tema per dashurine. Ndoshta ajo zhvendosej gjithnje ne harrese me takimin e ri, ne prekjen e dyte, te treten ndoshta ne te katerten, sa here qe pershkon Toka shtigje te pashkelura ne dashuri gjate nje viti perqark Diellit. Dashuria eshte levizje. Rrotullim. Nisje ne castin e prekjes se pare:

E embel eshte prekja e dashurise

Thesar I cmuar

Formulen e ka konstante ne pasqyren e university

Fatin e ka idil perkdhelas ne kopshtin "Firdevs"

Denimin e ka zjarr qe gelltit te gjiths

Edhe endrren

Edhe shpresen

Edhe jeten

E bukur eshte prekja e dashurise

thesar I cmuar

Celesi I saj eshte kopsht trendafilash

me ere te kendshme

e prekja e saj

rreze dielli qe deperton ne gjak

**Ke enderron
prekja e dashurise
SHPRESA NE JETE!?**

NE PREKJEN E DYTE

Dashuria eshte fole e fantazise. Nuk ka fole te ngrohete ne dhe te huaj - foleja ime eshte ne token qe quhet (I)liri. Aty ku valon Shqipja; ne vatren e Arberit. Dhe do ta mposht eliten e shekullit te dreqit. Ejani bashkarisht ta mbrojme folene tone te shtrenjte! Ejani se vetem keshtu ate mund ta bejme te lire, te gjalle, te mos vdes...

**Ajo eshte drite qe ka fuqi.
Ka levizje. Ka gjalleri.
Ajo eshte shqiponje.
Ajo fluturon...**

Po. Ne naten e 11 gushtit... une me syte e mi e pashe: pusine e shkendijes se zjarrte, qe fatin e Shqipes e mbronte ne qiell, me perplot roje te forta dhe me zjarr qe djeg, gjuante xhindet dhe Perbindeshin e pangopur, qe donin ta dine se cka bisedohet tek engjejt me te larte per percaktimin e Shqipes, mbi poret e ketij trualli, ku perjetohet cdo gje me ngrohetsi, me thjeshtesi, si mjekrra e detit dhe si prekja e dashurise. Kush e di se cka ndodhi ne 11 gusht... (1999)?!

**O laps I zi dhe shufer e shkrumbuar ne maje
Kujt I shkrove
Edhe ditën
Edhe muajin
Edhe... (vititn)?**

Ky ishte perfundimi I castit dhe I prekjes se dyte. Epilohu I fontanes: vazhdimesia e formulas ne univers. Zbulim I celesit magjik ishte ujevarena e zemres, e ajo eshte gjak dhe perzihet me dashuri. Vetem kjo dashuri ty, oj Shqipe, ta jepe lirine!

Ajo lexon ne zjarrin e Diellit
Ajo prek laven e vullkanit
Ne endrren time. Apo jo?
Te (p)(r)(e)(s)... UZI!?

Ne prekjen e trete

Natyra e shkrimtarit nderron kur ai e nderron stilin ne shkrim. Me rendesi eshte stili I imagjinuar ne kohe te caktuar. Ne enderr e jetova castin e prekjes se trete qe rishtazi pershkova shtigje te pashkelura ne dashuri. Cager:

Dashuria eshte dergje melankolike...
Percaktimi I objektit eshte sherim I saj

Cka pashe ne enderr? Po ta shohesh ne enderr Engjellushen e gjen krejt te mistershme - nje nga ato vajzat e pjekura e te lezetshme qe shpesh te ze syri ne rruget e carshise se Shkupi. E embel me sy te zinj e shume te vegjel, por te gjalle, kendshem provokuese e mbeshtjelle ne nje mantil prej mendafshi te kafte e te gjere, ne nje shami te larme gri qe fshehin floket dhe me kembet e forta sportive, ne maje te cakeve te larta.

E megjithate kjo vajze, e vetmja Engjellushe ne SHLP, me ze te ngrohte e melodioz dhe vetem 23 vjec, eshte kryetare e klubit te aerobikut qe, sapo arriti ne kete post, skandalizoi gjithe Shkupin.

Lidhja ime me Engjellushen eshte, ne fakt, muza e celesit e nje dashurie krejt te jashtezakonshme - dashuri qe rrefen ne artin e letres pasionin me dhembjen dhe ngacmon Engjellushen me fjalet e shkruara ne anglisht.

"Une nuk genjej por zbukuroj genjeshtren", ishte fjalia e pare. Kurse e dyta: "Kjo nuk eshte biografia e jetes sime, por eshte "love story" (i syrit tim). Dhe e fundit: "A nuk eshte keshtu?"

Engjellusha tha: "Kurre me mos te shoh fjale te ketilla! E une e kuptova ndryshe: "Dua te shoh fjale me kuptim me te kthjellet".

Pohova me neveri dhe u ndava nga Ajo (Engjellusha) dhe mora rrugen e mendimeve...

Po t'I besoj revoltës ose pergjegjesisë së Engjellushës, në mjegullën e artit tim është e perzier përherë genjeshtra. Cdo njeri në hap të parë genjen, tenton të paraqitet ai që nuk është. Kjo tregon se fantazia është një virus tepër i përhapur eksitimi qofte të meshkujt qofte të femrat. Shpesh fantazohen skena seksuale të cilat nuk mund të kryhen realisht dhe janë nga më të çuditshmet. Fanatazitet e femrave janë me romantike: për gjithçka e vetëm për suvenir në shtrat, ndërsa të meshkujve priren ndaj aktit seksual: ekziston vendi ku orgazma fillon dhe vendi ku orgazma mbaron - e prekja e trete asgjë më tepër nuk kërkon!

Në prekjen e katert

Ekziston casti dhe prekja e katert. Ekziston keshilla që e udhëzon dashurinë, vlera e së cilës dihet në dimmer. Ekziston kujtesa e Aleksandrisë. Profesoresha zbulon: "Dashuria verore dhe dashuria dimerore".

Në ditarin tim kam edhe shkrimet për një pushim veror dymbëdhjetë ditësh në Aleksandri. Po them se kërsherine më të madhe e kam kur shfletoj ato faqe, kur vitet e jetës universitare, bashkarisht me mbresat e tjera të kohës, bashkë me dëshirën për të mesuar dhe përpjekjet për të kuptuar lidhjet që bartnin republikë - bashkim - liri e drite, kur kaloja pushimet verore në Egjipt, ndonjëherë më shpënin edhe në jete romantike. E dija se koha mërr skenën e ngjarjeve më të rëndësishme, e më atë skenë hyne edhe në ditarin tim, që nesër serish të dale para syve të mi, dhe ja, sic është rasti më një fjale të shkruar arabisht:

DASHURIA VERORE DHE DASHURIA DIMERORE

Ne te verte kasha qene ne plazhin me te madh te Aleksandrise dhe ate pushim veror per shume cka, kur me ra ne sy kjo fjali, jo vetem qe e mbaja mend mire, por m'u kujtua edhe fytyra e asaj profesoreshe qe ne cdo mbremje, pas kthimit nga plazhi, me shoqeronte ne kafe ne sallonin e bukur te hotelit "Sheraton Munteza". Sikur edhe nje here te isha bashkebisedues I saj ne Aleksandri!

Fytyra e profesoreshes ishte e bukur dhe magjepsese, qe gjithsecili mashkull ne hotel ia ngjante ndjenjen e dashurise. Ajo ishte nje grua qe ti mund vetem ta endrrosh ne imagjinen tend te korrumpuar, ta perfytyrosh levizjen e lehte te trupit dhe me pamjen e lezetshme te saj te perplasesh ne shtratin e nje mije e nje neteve. Po ama te mbyllesh I vetmuar edhe ne ankthin e kater mureve. Keshtu, c'te besh, eshte natyra e njeriut qe lengon nga frika...

Ne te shtaten nate I dhurova asaj dashuri e ajo me dha ate qe quhet: dashuri verore dhe dashuri dimerore. Ti deshiron te ngjallish ate cast qe ndryshe quhet edhe dashuri pragmatike, me tha profesoresha. I thashe: kesaj te fundit ne shqiptaret I themi: me shkym zjarr - ate une edhe po e kerkoj prej teje. Por nuk po e kuptoj ate te paren - dashuri verore dhe dashuri dimerore - c'eshte kjo...? Me pergjigjet: shembulli I ketyre dyjave eshte si shembull I portokallit veror dhe portokallit dimeror.

Kur degjova kete u befasova dhe kersheria e menjes me nxiti qe nga ajo te kerkoj shpjegimin rreth dashurise verore. Ndersa ajo ne menyre alegorike me thote: dashuria verore eshte si portokalli veror. U ndala per nje cast dhe u thellova ne analiza... me ra ndermend se egjiptianet per portokallin veror thone se eshte pa shije dhe pa kurrfare lezeti, ngase piqet ne kohen kur nuk eshte koha e vet, dhe egjiptianeve nuk ua ka enda sic ua ka enda portokallin dimeror. Pyes profesoreshen: Si mund qe dashuria verore te jete pa shije, pa lezet? C'lidhje mund te kete dashuria me stinet: vere apo dimer?

-Dashuria verore me se shumti lind ne plazhe ose ne qytete bregdetare ku njerezit I kalojne pushimet verore. Natyra eshte e bukur dhe te ben te magjepsesh. Te reja dhe te rinjte, aty per aty, pa ndonje lidhje te forte stabile dhe emocionale, me euforine e epshit njeri-tjetrit I thone:

romansi, te dua, besom, te lutem, per mua kjo do te jete dashuria e pare dhe e fundit. Pastaj degjoj m'u per keta te rinje: u fjalosen, u shane u ndane. C'eshte me e keqja - kur dashurine e shnderrojne ne urretje, e urretja, thone, eshte fillimi I cmendurise, qe percillet me alkool, me kurveri, me narkomani etj... Te gjitha keto kane si qellim degjenerimin total dhe rrugen pa kthim ne ardhmeri. Eshte e vertete se faji lind mu atehere kur ai apo ajo (te pavetedijshem per pasojat qe mund te lindin) demistifikojne dhe zhveshin fshehtesine ose misterin e portokallit dimeror dhe me kete humb pastertia virgjeroe. Lind tradhetia.

Keshtu u pergjegj profesoresha e Aleksandrise.

Ne kohen e sodit dashuria eshte krijese jetime. Jetime sepse askush se mbron dhe nuk e edukon askush. Disa njerez flasin per dashurine, por sikur ajo te mos jete ndjenje, dhembshuri, shushuritje, perkdhelje etj. Keta njerez "kompjuterik" dashurine e kane shnderruar ne "CERI 2000", Shumica prej tyre mundohen t'I drejtojne ndjenjat e tyre ashtu sikurse I drejtojne veturat e tyre. Keshtu e shnderrojne dashurine prej koncertit te pianos se Shopenhauerit ne te renit e daulles: me shkym zjarr... (sic the ti: alla shqiptarqe). Ruajna o Zot! Dhe serish dikush thote se e kupton, e cmon ndjenjen e dashurise - (e nderprese une) n'hamam te Hyres, sic thote babi im.

Ajo vazhdon dhe prap keshillon:

Dashuria eshte thesar dhe instrument I fshehtesive te Zotit. Ajo as me arin e as me diamantine s'mund te krahasohet, sepse peshon me shume se gjithe pasuria e tokes. Ne njeriun ky thesar pasqyron tere universon me valet e amsheshmerise se perhershme - kopshtin "Firdevs".

Keshtu e mbaj mend profesoreshen e Aleksandrise.

Une I them syzezes (Aides) dhe I shkruaj:

Te mos kuptosh dashurine, s'eshte ndonje leshim katastrofal, eshte vetem humbje e thesarit me te cmueshem, kurse te capalladisesh me provokime si kurve, madje te mos I japish mikut tend kohen me te pershtatshme te dites per seks, eshte mbytje vetem e nje epizodi erotik

ne eksitim; eshte leshim... Dhe ky leshim kurven e vret ne tru. Aty ku banon seksi...! Por...

"There is something wrong in this world" kendojne syzeze Aerosmith. Ti e kupton gjuhen e seksit!?

Sot jam larg nga profesoresha e Aleksandrise dhe vetem une e di se c'deshi ajo te me thote, por nuk e kuptuan dot prirjet e aktit seksual, ndaj I vetem do te ndryje ne shpirt brengen per ate mekanizem kerkues qe levizi fuqishem ne prekjen e katert. Une e di gjithashtu se ajo qe nxori ne drite: dashurine verore dhe dashurine dimerore, eshte vetem nje prekje, nje copez prekje qe ra kalimthi ne shtrat me artin e shkrimit, e nuk u degjua britma e kenaqesise nga fantasia e endrres. Dhe fantasia levize ne eroskop:

"Ti e ke Akrepin tend dhe jeton nga flaka e xhelozise, e bene kete si me inat, qe ne fund t'I futish vetes thumbin helmues. Une ekam Peshoren time qe pershkoi shtigje te pashkelura ne dashuri, e bej kete si me qejf, qe ne fund t'I gjej vetes dhe prekjes muze shkrimi poetik".

Larg nga njerezit dhe politika: ne kerkimin e kohes se humbur. Dhe koha e humbur e permbyll endrren ne eroskop me poezi:

O prekje e embel... (sygeshtenje)!
A s'do te ishte me mire qe edhe ne jete
ashtu e embel te me vish ne shtrat
sikur edhe ne prekjen e endrres sime?

Nga fantasia... Ne jemi dy pale ne Nje
te cilet duhemi kur enderrojme.
ne prekjen e pare, ne te dyten,
ne te treten
ndoshta ne te katerten,
por e vertea eshte vetem art ne leter.

Duhet te ruhemi nga prekja ne eroskop
dhe enderrat,
por ngandonjehere ato jane me te mencura

sesa njerezit dhe politika!...

NE VEND TE EPILOGUT

1. Autobiografi

**Kam lindur me 1966 ne Shkup
Ezani. Zogu. Hoxha. Berisha
Musa ne Peshore.**

Filloren ne Shkup.

Ne moshe trembedhjete vjec, talebe

**ne medresen "Ala Udin" ne Prishtine
tetembedhjete vjec, student ne universitetin**

"El Ez'her" te Kajros.

Njezet e gjashte vjec, ne "Haxhi Jonus",

imam I emeruar me dekret.

**Dhe shtate vjet qe gdhendi shpirtin ne letrat
shqipe.**

Ne jete rebel dhe mekatar pa u bere dreq.

Per fat, idealin tim e kam ruajtur gjithmone

Ne melodine e Zotit.

Dhe cka mund te me ndodh

Une e di - pse e di Zoti!?

2. Autoadrese

**Shtepi ne Dizhon. Mahall me gur. Cati me teneqe.
Sokaku I ngushte me shume kthesa. Pa drita. Terr.
Rrapllime. Sirene. Ne sokak lehje qensh ne blu.
Ulurime zagaresh ne strehe. Hije e keqe ne gjum.
Rrotullohesh ne shtrat. Zgjohesh me gjelat. Uje.**

**Ndez driten I pari: jam ne ceshme I pari.
Vishesh. Ne fytyre I lagur. Mendon nisjen...**

3. Autorrugje

**Perjashta. Ne sokak. Vene kemben ne biciklete.
Hahesh me shpejtesine. Zihesh me fryme. Rrugës.
Qetesi. Ushtime ne veshe. Pastrim ne shpirt.
Mberrine ne Gazibabe. Hyn ne oborr. Ne xhami.
Askush. Vete. Ne pritje ezanin. Njerezit. Faljen e dyte.
Ne "Haxhi Jonus".**

4. Autoskice

**Qendrimi: me sy lart ne qiell. Pa re.
Yje shume dhe hena ne fshehtesi.
Me kap dicka ne kujtese...
S'ndez dritat ne minare
Vete jam drite!
Ky cast ka trajten e inspirimit.
E prek syri kupen e qiellit.
Mendja vizaton skicen ne hapësire.
Trupi levize ne heshtje.
Vec per xhami kam prekur drite te zbulimit,
Per fat, project buze nje ylli.**

5. Fotoatentat

**Lajm I bardh, I bekuar, qebesa. Ti po e merr vesh
Cka vjen pas kesaj. Mbete shpirt I rebeluar! Edhe
Me shkrim te ndaluar, pa ze qe ka me te ngjalle!?
Ai eshte ne fron, te tjeret ne labyrinth te huaj, te
Gjithe jane ne prite, pse kane mprehur dhembet**

**Per te m'I thyer kembet. Do te hidhen ne gryke.
Prapa shpine, te m'I qesin syte.**

**Je njeri kontradiktor. I vrazhde, I rebeluar.
Njeri aksidental!**

6. Autoringjallje

**Po ti ke deshmi te gjalla. Tullat prej balte. Shkrimin ne Flake.
Me balle ti puthe mihrabin I pari pese here ne dite.
Ktheve miraxhin dhe farzin ne vend. E vure gurin ne token e vet.
Ne (I)liri. Me popullin e vet. Ne pritjen e shekullit te engjellit:**

Nurit

Drites

Shkendijes...

**Kajro - Shkup
1984 - 1994**